



Koha



EDITORIAL

Menopauza trunore!



Tani kur dëgjojmë Hashim Thaçin teksa flet për ndryshim kufijsh në Ballkan, të krijohet përshtypja sikur po bëhet fjalë për një rrëfim që vjen pasi e kemi shikuar një film horror dhe secili në psikikën e tij krijon parabolat e rrezikshmërisë. Por, në fakt, nëse del ajo çka po thotë Hashimi, horrori mund të ndodhë, ndërkohë që askush s'po e merr seriozisht rrezikshmërinë e pasojave që mund të sjellë ky film i montuar keq në...

Fq.2

RAJON

S'ka zgjidhje të lehtë për Kosovën, i kemi vetëm dy rrugë përpara

Fq.14

GLOBI

Venezuela, një vend që po shpërthen nga brenda

Fq.15



MAQEDONIA RIT EKSPORTIN ME VENDET E BE-së, BIE NË RAJON

PËRGJYSMOHET TREGTIA ME KOSOVËN



Shtatë vitet e fundit, Maqedonia po e humb tregun e Kosovës edhe përkundër shifrave statistikore se vazhdimisht kemi shënuar suficit sa i përket eksportit të mallrave kundrejt importit të mallrave nga Kosova

Fq.6

KSHZ shtrëngon rripin për Referendumin

Shkup, 7 gusht - Komisioni Shtetëror Zgjedhor do të shpenzojë jo më shumë se 169 milionë e 770 mijë denarë për zhvillimin e Referendimit për marrëveshjen me Greqinë që do të zhvillohet në 30 shtator. KSHZ në seancën e së martës ka miratuar njëzëri planin financiar për organizimin e Referendimit, i reduktuar 20 për qind nga rialokimi i fundit i Parlamentit, ose 210 milionët e planifikuara. Kryetari i KSHZ-

së, Oliver Derkovski, ka bërë me dije se janë munduar që të racionalizojnë në maksimum shpenzimin e fondit dhe të mjetëve financiare në zëra të veçantë.

"Ky është vetëm plani financiar dhe kjo shifër nuk është definitive. Ne shpresojmë se mbas përfundimit të tenderave, mjetet financiare do të vazhdojnë të reduktohen, me qëllim shpenzimin në mënyrë sa më racionale..."

Fq.4



EDITORIAL

MENOPAUZA TRUNORE!



Emin AZEMI

Merre si ta marrësh, për të kuptuar më thellëse çka po ndodhë me ne, duhesh ta lexosh ose shtypin europian, ose ndonjë analist amerikan, sepse pushimet verore na kanë nxjerrë prej taktit dhe s'po mundemi të bëjmë bashkë dy kokrra mend për të shprehur një qëndrim sagllamë

Tani kur dëgjojmë Hashim Thaçin teksa flet për ndryshim kufijsh në Ballkan, të krijohet përshtypja sikur po bëhet fjalë për një rrëfim që vjen pasi e kemi shikuar një film horror dhe secili në psikikën e tij krijon parabolat e rrezikshmërisë. Por, në fakt, nëse del ajo çka po thotë Hashimi, horrori mund të ndodhë, ndërkohë që askush s'po e merr seriozisht rrezikshmërinë e pasojave që mund të sjellë ky film i montuar keq në laboratorët e Parisit a Beogradit. Mundësia për të bërë analiza është shumë e madhe, por variabiliteti i vërtetësisë sillt nga — o në + o.

Shqiptarët në Ballkan nuk arritën ta ngrejnë një Institut të hairit për të marrë vesh se çka do të ndodhë me ta në të ardhmen, siç e kanë popujt tjerë dhe, për pasojë, ne jemi të detyruar të dëgjojmë turlit autori se si na e rrëfen fatin tonë, paçka se këto rrëfime mund të jenë të mbushura më shumë me nebuloza se sa më ndonjë tharm të mirëfilltë studimi. Me këto universitete që vazhdojmë ti trajtojmë si ofiçina për fotokopjim diplomash (çdo respekt për përjashtimet), nuk mund të ndërtojmë kurrfarë projekcioni shkencor për rrethanat në të cilat lëviz gjallimi ynë ekzistencial, social, politik e kulturor. Derisa ta marrin vesh universitetet dhe akademitë tona se çka po ndodhë me pasojat që sjell, bie fjala, ndryshimi i kufijve, neve na ka hëngër ujku me tesha vesh. Jo pse tani ndodhemi në kulmin e pushimeve verore dhe ndokush mund të arsyetohet duke e paraqitur rrezitjen në diell si hendikep i një mospërgjigje akademike mbi atë çka po ndodhë rreth nesh, por edhe sikur të ishim në çfarëdo stine tjetër, mendimi ynë shkencor e studimor ndodhet në njëfarë "menopauze trunore" dhe askush s'e di se kur do të kenë "marrëdhënie të rregullta" dija dhe politika, emocionet dhe pragma.

Nëse e ndjekim me vëmendje debatin rreth "ndryshimit të kufijve" që do të sillte njëfarë shkëmbimi terriroresh, do të vërejmë se shqiptarët më shumë e kanë inatin ndaj njëri tjetrit, duke hedhur akuza reciproke, se sa që kanë ndonjë qëndrim të strukturuar shkencërisht e institucionalisht, i cili do të merrej si bazë negociimi për ndonjë zgjidhje eventuale, që mund të jetë e dhimbshme. Tek shqiptarët po preferohet dhimbja të jetë titanike, e përqendruar në dy, tre burra shtetesh, kurse pasojat të jenë kolektive, por pa kurrfarë mundësie për kërkim përgjegjësie për dështimet eventuale në të ardhmen.

Pra, merre si ta marrësh, për të kuptuar më thellëse çka po ndodhë me ne, duhesh ta lexosh ose shtypin europian, ose ndonjë analist amerikan, sepse pushimet verore na kanë nxjerrë prej taktit dhe s'po mundemi të bëjmë bashkë dy kokrra mend për të shprehur një qëndrim sagllamë. I keni vërejt komunikatat që vijnë prej disa profesorëve dhe akademikëve tanë (kur nuk janë në pushime verore), se çfarë "nasihatit" del prej fjalive të tyre dhe krejt në fund mbetesh pa përgjigjen kryesore: Çka më tutje? Edukimi që prodhon eklektizëm mendimesh, pa një orientim të qartë, është më mire të pushojë së krijuari iluzionin e rrejtshëm se gjoja kemi potencial intelektual e akademik.

Çka do të në hynte në punë konsulencia e vonuar shkencore, nëse dëmet e politikës së keqe janë të pariparueshme?

MBËSHTETËSIT E VEGJËLTË IDEVETË MËDHA

"Ideja për korrigjimin e kufijve ose për shkëmbim terriroresh, nëse gjen zbatim, nuk do t'i japë Kosovës asnjë pëllëmbë nga Lugina e Preshevës, siç pretendohet, por do t'i sigurojë veriut autonomi terrirore. Me pozitën e saj aktualisht të pafavorshme, Kosova e politikës reale, jo e retorikës folklorike, nuk do të jetë në gjendje të imponojë as zgjidhje simetrike të Luginës së Preshevës me asociacionin e komunave serbe, e jo më ndonjë gjë më shumë se kaq.

Idetë kombëtare janë ide të mëdha dhe brenda tyre përpiqen të akomodohen edhe ata që i ndajnë me krejt qenien e tyre problemet e kombit, pra patriotët e vërtetë, por edhe ata që e përdorin kombin për pushtet, për prestigj të rrejtshëm, për përfitime politike, për përfitime materiale etj., sepse, siç është thënë tashmë, patriotizmi është vërtet ndjenjë fisnike, por është edhe strehë për t'u fshehur edhe horrat dhe krejt soji i tyre. Te ne, meqë tashmë kemi arritur një shkallë të demokratizimit të mendimit, të drejtën për të ndarë "etiketa" kombëtare e kanë të gjithë, edhe ata, të cilët që më shumë se njëzet vjet përdorin retorikën patriotike "bam-bam-bam!" për të heshtur oponencën, por edhe ata që në emër të kombit vërtet nuk kanë lënë gjë pa bërë...", ka komentuar në Facebook zhvillimet e fundit shkrintari Mehmet Kraja.

KOSOVA PARA AKTIT TË KRYER

"Sot filloj dita me lajmin se Statuti i Asociacionit të Komunave Serbe shkon direkt në Bruksel, pa u shqyrtuar fare në Kosovë. Ky veprim e vë Kosovën pothuajse para aktit të kryer. Kuvendi ka ratifikuar Asociacionin, që do të thotë nuk ka më punë me këtë marrëveshje. Shpresa e vetme ka qenë Gjykata Kushtetuese dhe konfirmimi që ky Statut është në përputhje të plotë me Kushtetutën e vendit. Po m'dukut po i shoh liderët e shtetit të Kosovës e Serbisë: kosovarët tu u mburrë që Kosova nuk ndahet, serbët tu u mburrë që u bë Asociacioni. Epilogu final i kësaj marrëveshje-katrahurë politike e sociale", shkruan në profilin e tij në Facebook, analisti nga Prishtina, Artan Murati.

TURMAT E MASHTRUARA QË LINDIN NË TAVOLINAT E FB

"Sot gjithkush mund t'i vërë vetes një emër 'agjencie' e të shpikë 'lajme' sipas oreksit apo qellimeve të tij duke dëfryer ata që nuk duan të gjykojnë, por i marrin si të mirëqena. Kështu krijohen turmat e mashtruara dhe të rrezikshme që lindin në tavolinat e FB", ka shkruar në Facebook gazetarja nga Tirana, Albana Lifschin.

MEDIA Citate



KURTI: JOADEKUATE DHE E RREZIKSHME SHPREHJA "KORRIGJIM I KUFIJVE"

Në vazhdim të tryezës për të drejtat e shqiptarëve që jetojnë në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc të cilën e organizoi Lëvizja Vetëvendosje në Kuvendin e Republikës së Kosovës në fund të muajit korrik, kryetari Albin Kurti, i shoqëruar nga Hydajet Hyseni, Kryesues i Këshillit të Përgjithshëm, dhe, deputetja Fitore Pacolli, priti në takim Kryetarin e Komunes së Bujanocit, Shaip Kamberi, dhe, shefin e kabinetit të tij, Rahim Salihu. Kurti e informoi Kamberin rreth diskutimeve që kishte Kryesia e kësaj partie në mbledhjen e saj të djeshme rreth zhvillimeve të fundit që prekin komunat e Preshevës, Medvegjës e Bujanocit. Sipas kumtesës për media, Kurti e konsideroi joadekuate dhe të rrezikshme shprehjen "korrigjim i kufijve" të Presidentit Thaçi.

Kjo sipas tij, meqenëse korrigjimi i kufijve do të thotë korrigjim aty-këtu i ndonjë hapësire të vogël me ndonjë fshat, zabel a kodrinë, por jo përfshirje e një krahine të tërë siç është zona e komunave të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit, e që duhet të trajtohen si tërësi dhe jo të ndara nga njëra-tjetra. Kurti tha se respektimi i referendumit të vitit 1992 është zgjidhja e vetme e drejtë duke shtuar se Serbia duhet që ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe të paguajë për dëmet e shumta të luftës dhe okupimit.

(Zëri, 7 gusht)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHTE FRANCESK ANTON SANTORI?

Francesk Anton Santori (1819-1894) ishte poet e dramaturg arbëresh. Ishte nga Shën Katerina e Kozencës. Studioi teologji dhe pjesën më të madhe të jetës e kaloi në manastir, prej nga u largua vitet e fundit. Që herët nisi të mbledhë këngë popullore arbëreshe e të krijojë edhe vetë në gjini e lloje të ndryshme. Francesk A. Santori lëvroi lirikën, poemën, novelën në vargje, romanin, dramën, tragjedinë, satirën e fabulën. Ai

shkroi shumë, por arriti të botojë pak. Ndër botime të tij janë: përmbledhja me lirika "Këngëtorja arbëreshe", poemat "Valle e haresë së madhe" dhe "I burgosuri politik". Është autor edhe i disa krijimeve satirike. Francesk A. Santori u interesua edhe për folklorin, i dha 20 këngë arbëreshe J. De Radës, la të pabotuara një përmbledhje këngësh popullore dhe 100 fabula të përkthyer nga Ezopi.

VAZHDOJNË QËNDRIMET PRO DHE KUNDËR VOTIMIT MË 30 SHTATOR

DEBAT I HAPUR PËR REFERENDUMIN

Ish-shefi i misionit të BE-së në Shkup, Ervan Fuere, ka propozuar debat gjithëpërfshirës të iniciuar nga Qeveria që të ketë sukses Referendumi për emrin. Fuere këtë e ka ndërlidhur me mungesën e transparencë së bisedimeve që ka zhvilluar Qeveria maqedonase me atë greke e që, sipas tij, tani është koha ta kompensojë me debat gjithëpërfshirës



FUERE: DEBAT GJITHËPËRFSHIRËS PËR REFERENDUMIN

Në kushte kur është caktuar data për mbajtjen e referendumit për marrëveshjen mes Greqisë dhe Maqedonisë, qëllimi i së cilës është zgjidhja e kontestit afatgjatë mes dy vendeve për emrin, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, e udhëhequr nga Zoran Zaev, për këto javë aq sa kanë mbetur deri në votim, do të duhet të fillojë fushatë të madhe informative, porositi ish-ambasadori i BE-së në Maqedoni, Ervan Fuere, në rubrikën për "Prizma". "Debati publik gjithëpërfshirës, në nivel nacional dhe lokal, do të



jetë me rëndësi thelbësore që qytetarëve t'u sigurohen të gjitha informatat e nevojshme, në bazë të atyre ata mund të sjellin vendim, nëse do t'i pranojnë kushtet e marrëveshjes ose jo. Ndërsa koha është e shkurtër. Nëse Qeveria vendos të përgjigjet ndaj akuzave se i ka munguar transparenca në udhëheqjen e negociatave të cilat çuan drejt marrëveshjes, kohën e mbetur ajo duhet ta shfrytëzojë, t'i përdorë mirë të gjitha resurset që janë në dispozicion, që të fillojë debat në tërë vendin", thekson Fuere.

dhe për anëtarët e organizatës sonë". Ndryshe, ish-shefi i misionit të BE-së në Shkup, Ervan Fuere, ka propozuar debat gjithëpërfshirës të iniciuar nga qeveria që të ketë sukses referendumit për emrin. Fuere këtë e ka ndërlidhur me mungesën e transparencë së bisedimeve ka zhvilluar Qeveria maqedonase me atë greke e që sipas tij tani është koha ta kompensojë me debat gjithëpërfshirës.

"Debati publik gjithëpërfshirës, në nivel nacional dhe lokal, do të jetë me rëndësi thelbësore që qytetarëve t'u sigurohen të gjitha informatat e nevojshme, në

bazë të atyre ata mund të sjellin vendim, nëse do t'i pranojnë kushtet e marrëveshjes ose jo. Ndërsa koha është e shkurtër. Nëse Qeveria vendos të përgjigjet ndaj akuzave se i ka munguar transparenca në udhëheqjen e negociatave të cilat çuan drejt marrëveshjes, kohën e mbetur ajo duhet ta shfrytëzojë, t'i përdorë mirë të gjitha resurset që janë në dispozicion, që të fillojë debat në tërë vendin", ka theksuar Ervan Fuere.

Me këtë rast Fuere ka shtuar se në kushtet kur është caktuar data për mbajtjen e referendumit për marrëveshjen mes Greqisë dhe

Maqedonisë, qëllimi i së cilës është zgjidhja e kontestit afatgjatë mes dy vendeve për emrin, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, e udhëhequr nga Zoran Zaev, për këto javë aq sa kanë mbetur deri në votim, do të duhet të fillojë fushatë të madhe informative. Nga ana tjetër në Greqi mediat shkruajnë për mundësinë e dështimit të referendumit në Maqedoni ndërsa Qeveria greke duhet të rrije e qetë për vitin 2018 sa i përket obligimit për të zbatuar marrëveshjen për emrin me Maqedoninë.

"Viti do të përfundojë dhe pala e Greqisë nuk do të ketë nevojë të

bëj ndonjë hap në procesin e çështjes së emrit Maqedoni-Greqi", kështu shkruan gazeta greke "Kati-merini" në analizën e saj për referendumin e marrëveshjes me Greqinë që do të mbahet më 30 shtator në Maqedoni. Sipas "Kati-merinit", Referendumi si skenar të parë ka dështimin - pamundësi e kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev për të ndërmarrë hap tjetër në procesin e anëtarësimit, kurse skenar të dytë ka kalimin - mundësi për zgjedhje parlamentare. Gazeta ka komentuar se Referendumi më 30 shtator në IRJM për miratim (ose jo) të Marrëveshjes në Prespë, në Athinë ndiqet në bazë të dy skenarëve. Në rast se hedhet poshtë marrëveshja, "Kati-merini" shkruan se "Zoran Zaev nuk mund ta ndërmarrë hapin e radhës edhe përkaj faktit se referendumit ka karakter konsultativ".

Skenari i dytë sipas "Kati-merinit" është një përfundim pozitiv dhe përmirësim të marrëveshjes, pas së cilës do të vijonte edhe procesi për ndërhyrje kushtetuese "që mund të zgjasë deri te muaji". "Bazuar në pozitën negative të deritashme të opozitares nacionaliste VMRO-DPMNE, nuk është e sigurt nëse sukcesi i referendumit do t'ua ndërrojë mendjen deputetëve të partisë që të aprovojnë ndryshime kushtetuese. Në këtë situatë, zotëri Zaevi do ta dërgojë IRJM-në në zgjedhje të parakohshme me qëllim që të zgjerojë shumicën parlamentare dhe ta shtyp VMRO-në. Shkurt, 2018 do të përfundojë, kurse pala greke nuk do të ketë nevojë të bëjë diçka", shkruan "Kati-merini". Sa i takon zhvillimeve politike në Greqi, "Kati-merini" përcjellë qëndrime të ndërkombëtarëve të cilët vlerësojnë se "shkuarja e Greqisë në zgjedhje të parakohshme, mund të jetë qorrsozak për marrëveshjen e nënshkruar në Prespë".

BOGOEVSKI: MË 30 SHTATOR, TË THEMI PO PËR ANËTARËSIMIN NË NATO DHE BE

Deputeti i shumicës parlamentare të udhëhequr nga LSDM dhe koalicioni, Pavle Bogoevski u bën thirrje qytetarëve dhe qytetareve, së bashku, me guxim dhe me përkushtim të marrin pjesë në sigurimin e të ardhmes së shtetit tonë. "Me marrëveshjen e arritur të Greqisë me Maqedoninë, për herë të parë në historinë e Republikës së Maqedonisë ofrohet shans më e drejtë dhe më e mirë, shikuar historikisht për sigurimin e të ardhmes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Për herë të parë kemi shans me të vërtetë vetë të vendosim për të ardhmen tonë. Me pranimin e Marrëveshjes së Prespës ne i pranojmë edhe përfitimet e tij", thotë Bogoevski. Me këtë Marrëveshje, sipas tij, identiteti



i Maqedonisë është përforcuar dhe mbrojtur njëherë e përgjithmonë. "Gjuha është siguruar dhe pranuar në formën e saj burimore pa kurrfarë fusnota, mbiemra ose shtesa. Shtetësia jonë është maqedonase, tani dhe në të ardhmen, ndërsa simbolet shtetërore siç janë himni, flamuri dhe stema nuk do të ndërrohen. Të respektuar qytetarë dhe qytetare, me pranimin e kësaj marrëveshje për herë të parë hapen dyert për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në BE dhe NATO, atje ku përkasin vlera dhe civilizimi", thekson Bogoevski. Ai shtoi se përkrahja e kësaj Marrëveshje dhe çështja e referendumit, për të ardhmen e Republikës së Maqedonisë është akt më i lartë patriotik.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 7 gusht - Nga organizata jo-qeveritare "Forumi për Maqedoni Demokratike" (FMD) të martën kanë dënuar ashpër qëndrimin e opozitës maqedonase kundër Referendumit dhe thirrjes së 30 organizatave dhe partive më të vogla politike për bojkot të referendumit.

"Forumi është kundër çdo përpjekje për kushtëzim të procesit të Referendumit dhe të ndryshimeve të mundshme kushtetuese si shkelje e të drejtës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, që të shprehen për vullnetin demokratik, por edhe për përcaktimin strategjik afatgjatë të dy faktorëve politik më të mëdha në shtet për deklarimin në referendum për këtë çështje. Forumi është kundër edhe përpjekjes për amnisti të disa individëve të dyshuar nga pushteti paraprak. Jemi të bindur se një amnisti e tillë do të paraqiste sulm fatal për shtetin e së drejtës në Republikën e Maqedonisë dhe për kredibilitetin e shtetit tonë", thuhet ndër të tjerash në reagimin e FMD-së.

Nga kjo organizatë vlerësojnë se zgjidhja e problemit Maqedoni-Greqi, përcakton pozitën e Maqedonisë në procesin e anëtarësimit në NATO dhe Bashkimin Evropian dhe se nuk duhet të shihet si përkrahje ndaj partisë në pushtet - Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM). Kjo organizatë e ka përshëndetur shpalljen e Referendumit dhe për të njëjtin ka vlerësuar "se pritët që një kohë të gjatë dhe se është kyç për integritet euroatlantike të Republikës së Maqedonisë, përcaktim strategjik afatgjatë i shumicës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, si

Si pjesë e masave të kursimeve janë heqja e bonuseve për anëtarët e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, të cilët do të mjaftohen vetëm me pagën mujore, ndryshe nga praktika e mëparshme ku edhe anëtarët e KSHZ paguheshin edhe me honorare gjatë periudhës së zgjedhjeve. Edhe për votimin në diasporë këtë herë do të reduktohen shpenzimet, duke vënë në dispozicion të procedurave të votimit punonjësit e ambasadeve dhe jo asistencë nga Maqedonia

Koha

Evis HALILI

Shkup, 7 gusht - Komisioni Shtetëror Zgjedhor do të shpenzojë jo më shumë se 169 milionë e 770 mijë denarë për zhvillimin e Referendumit për marrëveshjen me Greqinë që do të zhvillohet në 30 shtator. KSHZ në seancën e së martës ka miratuar njëzëri planin financiar për organizimin e Referendumit, i reduktuar 20 për qind nga rialokimi i fondit të Parlamentit, ose 210 milionë e planifikuara. Kryetari i KSHZ-së, Oliver Derkovski, ka bërë me dije se janë munduar që të racionalizojnë në maksimum shpenzimin e fondit dhe të mjetëve financiare në zëra të veçantë.

"Ky është vetëm plani financiar dhe kjo shifër nuk është definitive. Ne shpresojmë se mbas përfundi-

MIRATOHET BUXHETI PREJ 169 MILIONË DENARË

KSHZ SHTRËNGON RRIPI, MASA KURSIMI PËR REFERENDUMIN



KSHZ NUK KA TË DREJTË TË IMPONOJË PARAQITJE MEDIATIKE

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM), Këshilli për Etikë në Mediat në Maqedoni (KEMM), Instituti i Maqedonisë për Media (IMM) dhe Instituti për Studime të Komunikimeve (ISK) dënojnë mënyrën në të cilën Komisioni Shtetëror Zgjedhor i interpreton ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Zgjedhor në lidhje me paraqitjen mediatike për referendumin për emrin. "Ju rikujtojmë se ndryshimet dhe plotësimet e fundit të Kodit Zgjedhor, me të cilët legjitimohet propaganda politike në mediat e paguar me paratë e qytetarëve, kanë të bëjnë vetëm me organizimin e fushatave zgjedhore, e jo edhe me organizimin e referendumit për emrin. KSHZ-ja nuk ka kompetencë ligjore për të interpretuar ligjet, ndërsa sqarimi i Komisionit për paraqitjen mediatike për referendumin është i

paqëndrueshëm, pa bazë ligjore dhe i diskrediton pjesëmarrësit në referendumin. Është e paqartë prej nga KSHZ nxjerr të drejtën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, si organizator i referendumit t'i jep prioritet në paraqitjen mediatike, në krahasim me pjesëmarrësit të tjerë në referendumin. Kuvendi jo vetëm që fiton qasje të privilegjuar në mediat për propagandën politike për referendumin, por edhe shpenzimet për propagandën do të paguhet me para publike. Pjesëmarrësit tjerë në fushatën për referendumin jo vetëm që do të kenë qasje të kufizuar në mediat për propagandë, por edhe shpenzimet për reklamimin do të duhet t'i bëjnë vetë. Sqarimi i tillë paushall mund të rrezikojë seriozisht legjitimitetin dhe ligjshmërinë e referendumit dhe për këtë arsye KSHZ menjëherë duhet të tërhiqet", thuhet në reagimin e përbashkët të shoqatave të gazetarëve.

mit të tenderave, mjetet financiare do të vazhdojnë të reduktohen, me qëllim shpenzimin në mënyrë

sa më racionale të parave të tak-sapaguesve", ka thënë Derkovski. Si pjesë e masave të kursimeve

janë heqja e bonuseve për anëtarët e Komisionit Shtetëror Zgjedhor, të cilët do të mjaftohen

vetëm me pagën mujore, ndryshe nga praktika e mëparshme ku edhe anëtarët e KSHZ paguheshin edhe me honorare gjatë periudhës së zgjedhjeve.

Edhe për votimin e diasporës këtë herë do të reduktohen shpenzimet, duke vënë në dispozicion të procedurave të votimit punonjësit e ambasadeve dhe jo asistencë nga Maqedonia. Ende nuk dihet sesa është shuma totale që do të shpenzohet për Këshillat zgjedhorë në diasporë, pasi KSHZ është në pritje të informacioneve nga përfaqësitë diplomatike për kapacitetin e nëpunësve që posedojnë. Sipas planit financiar, për materialin zgjedhor do të vihen në dispozicion 27 milionë denarë, ndërsa 80 milionë denarë të tjera janë parashikuar si honorare për anëtarët e komisioneve komunale zgjedhore dhe këshillave zgjedhorë.

Paraqitja e diasporës, e cila do të votojë një ditë përpara mbajtjes së referendumit (29 shtator) fillon nga data 9 deri më 23 gusht. Forma e paraqitjes bëhet edhe përmes plotësimit të formularëve dhe aplikimit elektronik, nga individit ose edhe dikush tjetër i autorizuar. Në seancë KSHZ ka vendosur po ashtu që afati për vendosjen e listës me çmime dhe ofertave për prezantimin në media të zgjasë deri më 10 gusht.

Pushimet kolektive të fakulteteve kanë shkaktuar në panik te studentët, të cilët rrezikojnë të humbasin shanset për vendosje nëpër konvikte. Është vënë në lëvizje edhe MASH-i. Me një letër-qarkore që mban datën 1 gusht, ministri Ademi u është drejtuar universiteteve publike me kërkesë që t'ju dalin në ndihmë studentëve duke ua përgatitur vërtetimet e nevojshme për konkurrim

Koha

Evis HALILI

Shkup, 7 gusht - Koha e pushimeve nëpër institucionet e arsimit të lartë ka shkaktuar jo pak telashe

MASH LETËR-QARKORE UNIVERSITETEVE

TË NDAHEN NË KOHË DOKUMENTET E STUDENTËVE



për studentët, të cilët nuk arrijnë të sigurojnë vërtetimet dhe dokumente të ngjashme që lëshohen nga ana e fakulteteve. Nëpër universitetet ku ata studiojnë, jo rrallë herë ndodh që të gjithë të punësuarit në shërbimet e çështjeve studentore të marrin lejet e pushimeve dhe me këtë të mbyllin zyrat ku studentët duhet të marrin vërtetimet. Moskordinimi në caktimin

e datave të pushimit vjetor, për të punësuarit në shërbimet e çështjeve studentore, ka vënë në pikëpyetje konkurrimin e studentëve për vendosjen nëpër konvikte për vitin akademik 2018/2019.

Për studentët që nuk do të jenë viti i parë, afati i dorëzimit të dokumenteve përfundon më 17 gusht 2018, kështu që dyert e

mbyllura për disa ditë në zyrat e shërbimeve studentore kanë shkaktuar panik te studentët. Mirëpo, që të mos ndodh "e keqja", është vënë në lëvizje edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila u kujton universiteteve se duhet të jenë në shërbim të detyrës. Përmes një letër-qarkore, të nënshkruar nga ministri Arbër Ademi, gjashtë universiteteve publike në vend u kërkohet që ti pajisin studentët me dokumentacionet që u nevojiten atyre për konkurrim.

"Ju lutemi që t'ju dilni në ndihmë studentëve duke iu dhënë në kohë dokumentet e nevojshme për konkurrim, që të mund t'i paraqesin të njëjtat brenda afatit të caktuar kohor për vendosje nëpër shtëpitë e studentëve", thuhet mes tjerash në letër-qarkoren drejtuar Universitetit "Kirili dhe Metodi" në Shkup, Universitetit "Klimenti i Ohrit" në Mana-

stir, Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, Universitetit "Apostol Pavle" në Ohër, Universitetit "Goce Dellçev" në Shtip dhe Universitetit të Tetovës.

Në lëtrëqarkoren e cila mban datën 1 gusht, MASH ua bën me dije universiteteve në fjalë se afati i dorëzimit të dokumenteve për praninë në konviktet shtetërore dhe objektet tjera për vendosjen e studentëve përfundon në datën 17 gusht të këtij viti. Me Konkursin që ka shpallur MASH për këtë qëllim, në dispozicion të studentëve do të jenë 5496 vende, prej të cilave 1103 për studentët e vitit të parë dhe 4393 vende për studentët e viteve II, III, IV, V, VI dhe absolventët. Konvikti me kapacitetin më të madh të vendeve (980 gjithsej) është "Pellagonia" në Shkup, ndërsa me më pak vend (52 gjithsej) është konvikti privat "Logos" në Shtip.

MAQEDONIA NUK I KA PËRMBUSHUR UDHËZIMET NDËRKOMBËTARE

MONITORIM I DETAJUAR I KËSHILLAVE

Procesi i skriningut që pritet të fillojë në shtator në mënyrë të detajuar do ta përcjellë punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publike. Këto dy institucione gjyqësore, të formuar për të siguruar sundimin e ligjit dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, gjatë viteve të kaluar shpeshherë janë cilësuar si organe partiake, që në masë të madhe kanë kontribuar për politizimin dhe partizimin e gjykatave dhe prokurorive



kur flet për procesin e skriningut, thotë se si shumë vende të Evropës Juglindore, ashtu edhe Maqedonisë i nevojitet ndërhyrje rrënjësore në sferën e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut.

“Vlerësoj se Maqedonia, nuk ka mungesë të dispozitave të qëndrueshme ligjore. Mirëpo, problemi sipas meje, është se në vendin tonë nuk u realizua një revizion paraprak për të gjithë funksionet e gjykatësve apo prokurorëve, të cilët gjatë dhjetë viteve të fundit u keqpërdorën dhe që shkaktua dëme me montimin e rasteve gjyqësore. Suksesi i skriningut varet nga pastrimi i faktorit njëri. Reformat në gjyqësor vlerësoj se nuk bëhen me njerëz të cilët e kanë keqpërdorur pozitën e tyre apo kanë bërë krime të ndryshme. Prandaj, krahas kornizës ligjore e cila pritet të jetë temë e skriningut, legjislacionit të Maqedonisë i duhet një revizion për të gjithë ata persona (gjykatës dhe prokurorët) që i kanë shërbyer politikës dhe i kanë shkelur të drejtat e njeriut dhe të drejtat kolektive. Më tepër reformat në gjyqësor besoj se duhet të bëhen në aspektin individual se sa atë legjislativ”, thotë Selmani.

Ndryshe, Komisioni Evropian, në faqen e saj ku sqaron kapitujt, në pjesën e Kapitullit 23, thekson se vendosja e gjyqësorit të pavarur dhe efektiv është me rëndësi esenciale për çdo vend që dëshiron të bëhet pjesë e BE-së. Paanshmëria, integriteti dhe standardet e larta të punonjësve gjyqësor janë esenciale për sundimin e vërtetë të së drejtës. Mes tjerash, ata shtojnë se një kornizë e fuqishme ligjore dhe institucione të sigurta janë më së të nevojshme për vënie e një politike koherente për parandalim dhe pengim të korrupsionit.

Në prill të këtij viti, pas një procesi të mundimshëm negociatave mes pozitës dhe opozitës, në Parlamentin e Maqedonisë, u votua pakoja e parë e ligjeve të cilësuar si “ligjet reformistë”. Krahas plotësimit-ndryshimit të Ligjit për gjykata, Ligjit për Këshilli Gjyqësor, apo Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, përbërja parlamentare ende nuk ka arritur marrëveshje për miratimin e ndryshimit të Ligjit për prokurorinë p-



MARGARITA CACA NIKOLLOVSKA

Skriningu pritet të dëshmoj se në rast të hetimeve sa janë të siguruar të drejtat e tyre. Njëkohësisht analizohet e drejta e ankesës, pastaj qasja e Këshillave të apostrofuara. Pra, nëse para këtyre organeve zhvillohet ndonjë procedurë për gjykatës apo prokuror të caktuar, atëherë skriningu-ekipi nga afër do ta përcjellë këtë procedurë. Kryesisht, skriningu ka të bëjë me çështjen se çka shteti bën për të siguruar standardet e vendosura nga BE-ja



BASHKIM SELMANI

Krahas kornizës ligjore e cila pritet të jetë temë e skriningut, legjislacionit të Maqedonisë i duhet një revizion për të gjithë ata persona (gjykatës dhe prokurorët) që i kanë shërbyer politikës dhe i kanë shkelur të drejtat e njeriut dhe të drejtat kolektive. Më tepër reformat në gjyqësor besoj se duhet të bëhen në aspektin individual se sa atë legjislativ

blike, që parasheh përfshirjen e Prokurorisë Speciale Publike, si pjesë e prokurorisë së rregullt, e cila njëkohësisht pritet të hetoj rastet e rënda korruptive.

KRONIKË

Një motoçiklist lëndohet në një aksident në Shkup

Një motoçiklist është lënduar më rëndë në një aksident trafiku që ka ndodhur dje në orën 10:50 në rrugën "Skupi" në Shkup. Në aksidentin e trafikut, siç informon MPB-ja, kanë marrë pjesë një motoçikletë "BMW advenator" me targa të Shkupit i drejtuar nga B.H. (48) nga Shkupi dhe automjetit të udhëtarëve "Hundai I30" me targa të Shkupit, i drejtuar nga A.P. (50) nga Shkupi. Pas aksidentit B.H. me automjetet të Ndhmës së shpejtë mjekësore është dërguar në Spitalin e përgjithshëm të qytetit "8 Shtatori" ku nga ana e mjekut i janë konstatuar lëndime të rënda trupore. Është realizuar ekspertizë në vendin e ngjarjes dhe po punohet në ndriçimin e plotë të rastit.

17 vjeçarja largohet nga shtëpia

Të hënën në ora 12 e 30 minuta, në stacionin policor Tetovë ka ardhur personi M.P. (46) nga Tetova dhe ka denoncuar se dy ditë më parë, rreth orës 14.00, denoncuesi bashkë me familjen e tij kanë qenë mysafir dhe kur është kthyer në shtëpi diku rreth orës 17.00, gjyshi i tij e ka informuar se vajza e tij 17 vjeçare është larguar nga shtëpia në drejtim të panjohur, dhe deri në momentin e denoncimit, e njëjta nuk është kthyer në shtëpi. Merren të gjitha masat dhe aktivitetet, për gjetjen e vajzës së humbur.

Të shtëna me armë në Poroj

Të hënën mbrëma nga ana e disa qytetarëve anonim, nëpërmjet telefonit në Stacionin policor Tetovë, është denoncuar prishje e rendit dhe qetësisë publike, me krisma me armë zjarri, në lagjen "Drenovec" të Tetovës, rruga që shpie për në fshatin Xhermë. Menjëherë pas denoncimit, nga ana e ekipit patrullues nga Stacioni policor Tetovë, është kontrolluar tereni, dhe është konstatuar se në fshatin Poroj, ka pasur një dasëm në shtëpinë e personit M.L. 47 vjeçar, i cili ka treguar se nga ana e mysafirëve të pranishëm, ka pasur disa krisma por shkaku se ka qenë një numër i madh i mysafirëve, nuk ka mundur të vërehet se cili prej tyre ka shkrepur. Në vendin e ngjarjes janë vërejtur katër gëzhoja, të cilat janë siguruar deri në ardhjen e ekipit hetues, ku janë fotodokumentuar, dhe janë marrur për procedurë të më tutjeshme. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit, ku edhe do të pasojnë padi adekuate.

Dëmtohet vetura nga një plumb pa cak

Të hënën mbrëma personi R.M. 52 vjeçar nga fshati Tearcë, pjesëtarëve të policisë nga Stacioni policor Tetovë u ka denoncuar se disa minuta pak më parë derisa me veturën e tij me targa të Zvicrës, së bashku me familjen e tij, gruan dhe dy fëmijët minoren, ka lëvizur nëpër rrugën regionale Tetovë-fshati Jazhincë, kur kanë arritur në fshatin Xhepçisht në afërsi të varrezave, është dëmtuar vetura e tij me një plumb zjarri. Dëmtimi është fotodokumentuar, dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit. (U.H)

Shkup, 7 gusht - Skrining-procesi i Kapitullit 23 nuk nënkupton kontrollin e drejtpërdrejtë të punës së gjykatësve dhe prokurorëve. Kjo detyrë vazhdon të jetë kompetencë ekskluzive e organeve nacionale, respektivisht sipas Margarita Caca Nikolovskës, puna individuale e gjykatësve dhe prokurorëve të caktuar është detyrë e institucioneve shtetërore të Maqedonisë. Duke sqaruar se çka realisht nënkupton procesin e skriningut, Nikolovska për gazetën KOHA thotë se srkingu (pasqyrimi i gjendjes reale në gjyqësor), është të shikohet se si institucionet mbikëqyrës i trajtojnë shkeljet eventuale të prokurorëve apo gjykatësve.

“Po ashtu, skriningu pritet të vlerësojë se si organet gjyqësor, Këshilli Gjyqësor apo Këshilli i Prokurorëve, vepron në raste të tilla, gjegjësisht qëllimi i këtij procesi është të vërtetohet se vallë ekzistojnë vendime ligjore për të shqyrtuar shkelje eventuale. Tutje skriningu pritet të dëshmoj se në rast të hetimeve sa janë të siguruar të drejtat e tyre. Njëkohësisht analizohet e drejta e ankesës, pastaj qasja e Këshillave të apostrofuara. Pra, nëse para këtyre organeve zhvillohet ndonjë procedurë për gjykatës apo prokuror të caktuar, atëherë skriningu-ekipi nga afër do ta përcjellë këtë procedurë. Kryesisht, skriningu ka të bëjë me çështjen se çka shteti bën për të siguruar standardet e vendosura nga BE-ja”, thotë Nikolovska.

Gjatë periudhës së kaluar, puna e Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli të Prokurorëve vazhdimisht është monitoruara nga organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, siç janë Këshilli i BE-së apo Stejt Departmenti. Në këtë drejtim, ish gjykatësja Caca Nikolovska thekson se skrining-procesi, i cili pritet të fillojë nga shtatori i këtij viti, paraqet mbikëqyrje më të detajuar të punës së Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli të Prokurorëve Publikë.

Profesori universitar Bashkim Selmani,

Së shpejti kompensimet për dëmet e vitit 2015 dhe 2016

Shkup, 7 gusht - Ministria e Bujqësisë pret së shpejti të fillojë me kompensimin e dëmeve nga vërshimet e vitit 2015 dhe 2016. Procesi ende është nën bllokadë, por dekreti kontestues është shfuqizuar. Lëndët janë në Komisionin kompetent qeveritar, ndërsa është përgatitur edhe informacion që duhet të kalojë në seancë të Qeverisë. Pastaj vijon edhe pagesa e mjeteve, ka paralajmëruar sot shefi i Kabinetit të ministrit të Bujqësisë, Trajan Dimkovski. Duke u përgjigjur në pyetjet e gazetarëve, Dimkovski tha se për kompensimin e dëmeve për bujqit nga fatkeqësitë e motit në vitin 2018 ende nuk ka numër konkret pasi vlerësimi është në vijim e sipër. "Për vitin 2017 shuma që duhet të paguhet është rreth katër milionë euro. Sipas Agjencisë pagesore, pjesa e Resnjës është mbuluar tërësisht. Dëmet tjera paguhen, por sa saktë nga katër milionë janë paguar për momentin nuk mund të them. Për sipërfaqet bujqësore nuk është bërë asgjë në vitin 2016. Procedura është ngatërruar për shkak të dekretit famoz që e bllokoi krejt procesin. Kërkesat kanë arrit deri në Komisionin qeveritar për dëme, duhet të dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë. Gjatë kohë tentojmë të zhbllokojmë procesin", ka thënë Dimkovski. Lidhur me sigurimin e sipërfaqeve bujqësore, ai ka potencuar se trendi i zvogëlimit vazhdon. Sipas tij, madje në vitin 2015 ka pasur 5 mijë polisa, ndërsa vjet vetëm 2 mijë.

Ulen shpenzimet për jetesë

Shkup, 7 gusht - Shpenzimet për jetesë në korrik të këtij viti janë zvogëluar për 0,3 për qind në krahasim me muajin paraprak, ndërsa çmimet me pakicë janë rritur për 0,4 për qind. Në krahasim me korrikun e vitit 2017, megjithatë, shpenzimet për jetesë janë rritur për 1,7 për qind, ndërsa çmimet me pakicë për 3,3 për qind. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, ulje e shpenzimeve për jetesë në korrik të këtij viti në krahasim me muajin paraprak ka te perimet e freskëta dhe të ftohta, përveç te patatja dhe frytet rrënjore për 12 për qind, te pemët e freskëta dhe të ftohta për 2,3 vaji dhe yndyrat për 1,1 për qind, prodhimet e tjera të furrave për 0,6 miell dhe drithërat tjerë për 0,5 djathë dhe gjizë për 0,4 peshq të ngrirë, sheqeri, xhemi, mjalti, çokollata dhe prodhimet konditore për 0,3 për qind. Ulje është shënuar edhe te ujërat e zeza për 6,2 për qind, pajisjet fotografike dhe kinematografi dhe instrumentet optike për 5,9, karburantet e lëngshme për amvisëri për 1,7, pajisjet informatike për 1,5 për qind, karburanteve të lëngshme dhe vajra si pjesë nga pajisjet për mjete personale komunikacioni për 1,2, mjete për pastrim dhe mirëmbajtjen e banesës për 0,9, këpucë për 0,8 pajisje për pranim, xhirim dhe riprodhim të zërit dhe fotografive për 0,4 për qind. Rritje të shpenzimeve për jetë ka te pemët e thata dhe prodhimet me bërthamë për 0,9 për qind, jogurti për 0,6 për qind dhe peshku i freskët dhe i ftohtë për 0,5, mishi i thatë, kripur dhe tymosur, vezët dhe cigaret për 0,4 për qind, perimet e thata, perimet e tjera të konservuara dhe përpunuara për 0,3 për qind, drithërat, pemët e ngrira dhe prodhimet e tjera ushqimore.

MAQEDONIA RRIET EKSPORTIN ME VENDET E BE-së

PËRGJYSMOHET TREGTIA ME KOSOVËN



Shtatë vitet e fundit, Maqedonia po e humb tregun e Kosovës edhe përkundër shifrave statistikore se vazhdimisht kemi shënuar suficit sa i përket eksportit të mallrave kundrejt importit të mallrave nga Kosova

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 6 gusht - Eksporti i mallrave nga Maqedonia në gjashtë muajt e parë të vitit shënon rritje prej 26.5 për qind. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për Statistikë, vlera e mallit të eksportuar për periudhën janar-qershor të vitit 2018 është 3.323.298.000 dollarë amerikanë. Vlera e mallit të importuar në gjysmë vjetorin e parë është 4.441.172.000 dollarë amerikanë dhe shënon rritje prej 24 për qind.

Deficiti tregtar, në periudhën janar-qershor të vitit 2018, është 1.117.874.000 dollarë amerikanë. Mbulimi i importit me eksportin, në periudhën janar-qershor të vitit 2018, është 74.9 për qind. Rritja eksportit të mallrave është falë kompanive të huaja që funksionojnë në zonat e lira ekonomike, të cilat për orientim kryesor e kanë eksportin e prodhimeve drejt vendeve të BE-së dhe vendeve tjera të botës. Sipas të dhënave të Entit të Statistikës, gjashtë muajt e parë të këtij viti sipas vëllimit të përgjithshëm të këmbimit të jashtëm tregtar, Republika e Maqedonisë më së shumti ka tregtuar me Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë dhe at katalizatorë bartës me metale fisnike, pajisje të përcuesve për dëgjim për automjete, aeroplanë ose anije, pjesë të ulëseve për automobil dhe mjeteve transportuese me 10 ose më shumë ulëse.

Nëse Maqedonia deri në fund të vitit 2011 ishte partner numër një sa i përket shkëmbimit tregtar me Kosovën, sepse në këtë vit këmbimi tregtar me Kosovën kishte arritur shifrën prej 421 milionë euro, edhe atë mallrat e eksportuara nga Maqedonia drejt Kosovës shënonin vlerën prej 396 milionë euro, ndërsa mallrat e eksportuar nga Kosova në tregun e Maqedonisë kapnin shifrën prej 25 milionë euro, 7 vitet e fundit Maqedoni po e humb tregun e Kosovës edhe përkundër shifrave se Maqedoni vazhdimisht ka shënuar suficit sa i përket eksportit të mallrave kundrejt importit të mallrave nga Kosova. Nga janari e deri në fund të muajit maj të vitit 2018, kompanitë nga Maqedonia kanë eksportuar mallra në vlerë prej rreth 80 milionë euro, dhe krahasuar me vitin 2017, importi është rritur vetëm për 5 milionë euro, gjegjësisht në vitin 2017 Maqedonia drejt tregut kosovar ka eksportuar rreth 75 milionë euro.

Nga ana tjetër, kompanitë kosovare në vitin 2018 në Maqedoni kanë eksportuar mallra me vlerë tepër të ulët, vetëm 12 milionë euro, ndërsa krahasuar me vitin 2017, sa i përket eksportit të mallrave kosovare në tregun e Maqedonisë, ato kanë shënuar ulje prej 1 milionë euro. Eksporti i mallrave nga Kosova i hyrë në tregun e Maqedonisë në vitin 2017 kapte shifrën prej 13.204.524 eurove ndërsa pesë muajt e parë të këtij viti Kosova drejt tregut të Maqedonisë ka eksportuar më vlerë prej

12.216.778 eurove që është për rreth një milion euro më pak.

Në ndërkohë, Shqipëria dhe Maqedonia dy vitet e fundit kanë një fluks të lartë tregtar në importin dhe eksportin e prodhimeve bujqësore. Nëse tre vite më parë kompanitë nga Maqedonia eksporton më shumë mallra në tregun e Shqipërisë, dy vitet e fundit kompanitë nga Shqipëria kanë rritur eksportin e tyre drejt Maqedonisë. Volumi tregtar në pesë muajt e parë të vitit 2018 nga Maqedoni kap shifrën prej 27.806.248 euro, ndërsa në anën tjetër - mallrat e Shqipërisë në tregun e Maqedonisë janë futur në vlerë prej 21.057.453, këto shifra tregojnë se dukshëm dy vitet e fundit është përmirësuar raporti eksport import. Ndryshe, vitin e kaluar për periudhën e njëjtë Maqedonia në tregun e Shqipërisë ka eksportuar mallra në vlerë 24.292.854 euro, kurse mallra shqiptare janë futur në tregun e Maqedonisë në vlerë prej 23.799.183 euro. Gjatë viti 2017 dhe 2018, Shqipëria drejt tregut të Maqedonisë ka eksportuar produkte: domate, tranguj, peshk i freskët, agrumet e freskëta, prodhime brumi etj.

RRETH 180 MIJË EURO DËMI NGA DOGANA E KOSOVËS

Rreth 180.000 euro apo 2000 tonë eksport i parealizuar, vlerësohet dëmi prej vendimit të Kosovës me të cilin doganat për pemët dhe perimet u rritën për 30 për qind, tha dje shefi i kabinetit në Ministrinë e Bujqësisë, Trajan Dimkovski. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, Dimkovski theksoi se dëmet janë përllogaritur në bazë të eksportit të realizuar vitin e kaluar prej 18 deri më 31 korrik, periudhë në të cilën

këtë vit vlente vendimi i Qeverisë së Kosovës. "Kosova e vendosi vendimin me të cilin i rriti doganat më 18 korrik të këtij viti ndërsa më pas solli pezullim të pjesshëm ndërsa më pas vendimi u tërhoq tërësisht. Vitin e kaluar në këtë periudhë, prej më 18 deri më 31 korrik Maqedonia në Kosovë i ka eksportuar rreth 2.000 tonë produkte bujqësore në vlerë prej 180.000 eurosh", theksoi Dimkovski.

AKSION KUNDËR LUFTËTARËVE NGA SIRIA E IRAKU

“CELULA 3”, ARRESTOHEN SHTATË PERSONA

Pas një pauzë disa vjeçare, MPB ka vënë nën pranga shtatë shtetas nga Maqedonia, të dyshuar për pjesëmarrjen në luftërat e Sirisë dhe Irakut. Policia ka njoftuar se procedura e mëtejme para organeve përkatëse shtetërore për këta të arrestuar do të zhvillohet në bazë të shkëlqeve ligjore që i kanë kryer të arrestuarit në “Celula 1” dhe “Celula 2”



BFI: SHTETI I PAINTERESUAR PËR PROJEKTIN “STOP RAD-TERR”

Projekti “Stop Rad-Terr” i Bashkësisë Fetare Islame ende nuk ka filluar të zbatohet. Ndonëse vite më parë BFI e promovoi këtë projekt, cili synonte risocializimin e të burgosurve dhe familjeve që tyre që kanë marrë pjesë në luftërat e huaja, megjithatë deri më sot nga ky institucion fetare nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret. Zëdhënësi i BFI-së, Muzemil Osmani, duke sqaruar shkaqet se pse ky projekt nuk është zbatuar në praktikë, ka potencuar se të gjitha institucionet shtetërore dhe përfaqësitë diplomatike janë njoftuar me projektin e BFI-së. Mirëpo, për dallim nga këta të fundit, më herët asnjë institucion shtetëror nuk ka shpreh interes për realizimin në terren të këtij projekti. “E vërtetë është se projekti për momentin ka ngelur

vetëm i shkruar në letër. Mirëpo jo për fajin tonë. Ne si institucion në mënyrë të detajuar ia kemi treguar Qeverisë së kaluar synimin tonë. Por, fatkeqësisht, ato nuk na kanë përfill. Për dallim nga përfaqësitë diplomatike, të cilët kanë shprehur gatishmëri për të ndihmuar. Megjithatë, problemi nuk qëndron vetëm te mjetet materiale, por edhe te leja institucionale. Për të ligjësuar në ndonjërin prej burgjeve në vend, ne paraprakisht duhet të marrim leje nga Ministria e Drejtësisë, të cilën Qeveria e kaluar nuk na e ka siguruar. Mos të flasim për kushte dhe hapësira në burgje. Sidoqoftë, ne këtë projekt e kemi të gatshëm. Të njëjtin në kohën e fushatës parazgjedhore e ia kemi dorëzuar edhe kryeministrit aktual, Zoran Zaev”, tha Osmani.

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 7 gusht - Ministria e Punëve të Brendshme të martën e ka realizuar një aksion policor për arrestimin e shtatë personave të dyshuar për pjesëmarrje në luftërat e huaja në Irak dhe Siri. Përmes një kumtesë për media, MPB informon se ky aksion është realizuar në bashkëpunim me partnerët e Koalicionit global për luftën kundër terrorizmit dhe Forcat Demokratike Siriane. Dyshimet për të cilat ngarkohen shtatë të arrestuarit S.R., X.H.A., B.F., O.Z.H., E.O., I.SH dhe A.M., të gjithë shtetas të Maqedonisë, sipas policisë së shtetit, lidhen me pjesëmarrjen e tyre si luftëtarë të huaj në vatrat e luftës në Siri dhe Irak. Në një procedurë gjyqësore, e cila sipas të gjitha gjasave do të përfa-

qësohet nga Prokuroria për krim të organizuar, duke u mbështetur në të dhënat e publikuara nga MPB-ja, këtë të dyshuar pritet të ngarkohen për shkëlqen e nenit 322a dhe 394a, të Kodit Penale të Maqedonisë.

“Për vepra të ngjashëm policia

realizoi aksione policor në rastin ‘Celula1’, në gusht 2015 dhe ‘Celula2’, në korrik 2016. Në kuadër të luftës së Koalicionit global në luftën kundër terrorizmit, Maqedonia në mënyrë të vazhdueshme ndërmerr aktivitete për identifikimin, neutralizimin dhe përndjekjen penale të

luftëtarëve terroristë të huaj”, thonë nga MPB-ja.

Dispozitat e neneve të apostrofuara parashohin dënime të ndryshme me burg, duke filluar nga 1 deri në 5 vite heqje lire, të cilat llogariten si dënime më të vogla, në krahasim me ato për veprën pena-

le terrorizëm. Këto sanksione, Gjykata Penale e Shkupit në rastet e mëhershme të procedimit të lëndëve kundër pjesëmarrësve në luftërat e huaja, i ka shqiptuar në bazë të neni 322a. Tutje dënimet, më të larta për terrorizëm të cilët minimum janë 8 vite burg, Kodi Penal i Maqedonisë i ka paraparë në nenin 394a. Republika e Maqedonisë, si një ndër vendet e cila e ka pranuar Rezolutën 2178 të vitit 2014 dhe atë 2396 të vitit 2017 të Këshilli të Sigurisë pranë Kombeve të Bashkuara, siç njoftojnë nga MPB, vazhdimisht po ndërmerr masa për përndjekje penale të shtetasve të saj që kanë marrë pjesë në formacionet e ndryshme ushtarake në Siri dhe Irak, kthimin e tyre në vendlindje dhe respektimin e të drejtë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

“Ky aksion është një tregues i mjaftueshëm se institucionet e Maqedonisë kanë kapacitete dhe kredibilitet për menaxhimin e sfidave aktuale të sigurisë. Po ashtu, ky aksion e ka vërtetuar faktin se ne jemi një partner serioz i Koalicionit global për luftë kundër terrorizmit. Në pajtim me Strategjinë kombëtare për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit, Maqedonia realizon programe për deradikalizimin e luftëtarëve në të huaj në burgjet e vendit, ndërmerr aksione për rritjen e vetëdijes për rrezikun dhe kërcënimet nga terrorizmit dhe i përforcon mekanizmi për parandalim të radikalizimit në nivel lokal”, theksojnë nga MPB-ja.

Shkup, 6 të lënduar në 8 aksidente

Shkup, 7 gusht - Një person rëndë i lënduar, ndërsa pesë të tjerë kanë marrë lëndime të lehta në gjithsej tetë aksidente të cilat kanë ndodhur dje në territorin e Qytetit të Shkupit. Nga MPB-ja informojnë se policia e trafikut ka sanksionuar 36 shoferë të cilët kanë vozitur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, ndërsa 24 janë përgjashtuar nga komunikacioni. Gjashtë persona nga të përgjashtuarit kanë vozitur nën ndikimin e alkoolit, 13 kanë drejtuar makinat pa leje për vozitje, ndërsa dy kanë qenë fillestar. Gjatë kontrollit të automjetit, policia nga komunikacioni ka përgjashtuar 10 automjete nga të cilët nëntë kanë qenë të paregjistruara dhe një me defekte teknike. Me ndihmën e automjetit special karrotreci janë mënjanuar 46 automjete.

RRITEN REAGIMET KUNDËR AMBASADORIT TË RI TË KOSOVËS

AMBASADORI DEDAJ I PADËSHIRUAR NË MAQEDONI

Shkup, 7 gusht - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, edhe zyrtarisht ka nënshkruar dekretin për emërimin e zëvendësministrit aktual për Punë të Jashtme, Gjergj Dedaj për ambasador të ri të Kosovës në Maqedoni. Lajmin në faqen e Fejsbukut mbrëmë e kishte publikuar vetë Dedaj, ndërsa vazhdojnë reagimet negative kundër këtij vendimi të autoriteteve të Prishtinës zyrtare. Së fundmi, Partia për Lëvizjen e Turqve në Maqedoni (THP), ka akuzuar se është i prapranueshëm që Deda, siç thuhet në reagim, një person me mentalitet primitiv dhe fashist, të përfaqësojë Kosovën në Maqedoni.

“Partia për Lëvizjen e Turqve në Maqedoni (THP) si dhe i tërë opinioni turk në Republikën e Maqedonisë, por edhe më gjerë, me dozë të madhe të zhgënjimit dhe pakënaqësisë e morën lajmin se ambasadori i ri i Republikës së Ko-



sovës në Republikën e Maqedonisë do të jetë pikërisht personi Gjergj Dedaj, i cili më parë derisa e ka kryer funksionin e zëvendësministrit të Republikës së Kosovës, disa herë ka dhënë deklaratë skandalozë, ofenduese, përfundimisht fashiste ndaj po-

pullit turk. Jemi kategorik se një njeri i cili është me mentalitet të tillë primitiv dhe fashist në asnjë rast nuk guxon të jetë ambasador në vendin tonë i cili në të gjitha segmentet maksimalisht mundohet ta kultivojë dhe promovojë multietnicitetin si një nga përfiti-

met kyçe për tërë shoqërinë”, thuhet në reagimin e THP-së.

Besojmë, shtohet më tej, se në emër të promovimit të vlerave pozitive në tërë rajonin, por edhe për përforcimin e miqësisë me Republikën e Turqisë do t'i shfrytëzoni të gjitha kompetencat e juaja dhe nuk do të lejonit personalitet të tillë të emërohet si ambasador në Republikën e Maqedonisë.

“Partia për Lëvizje të Turqve (THP) dhe tërë opinioni turk në ditët e ardhshme me zgjuars do t'i ndjekin të gjitha ngjarjet dhe do të ndërmarrin hapa më radikale demokratike për zgjidhjen e këtij problemi”, thuhet në kumtesë. Në ndërkohë, reagime kundër Gjergj Dedaj ka edhe në mesin e intelektualëve shqiptarë të Maqedonisë, ndërsa tallje dhe ironizim me vendimin e presidentit Thaçi ka pasur dhe vazhdon të ketë edhe në Kosovë.


BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

SHPALLJE numër 3/2018
PËR SHITJE TË PRONËS SË TUNDSHME – AUTOMJETE
Përmes ankandit publik me gojë

Lënda e shitjes:

Banka popullore do të bëjë shitjen e automjeteve përmes ankandit publik me gojë edhe atë:

1. Citroen C4

Vëllimi punues i motorit	1360
Fuqia e motorit në KW	65
Viti i prodhimit	2008
Ulëse	5
Ngjyra	Metalik i kaltër 90
Numri i Lejes së qarkullimit	MK 1468331
Regjistrimi	JO

Çmimi fillestar i makinës është 130.433,00 denarë.
Makina shitet në parim e parë – e blerë.

2. Citroen C4

Vëllimi punues i motorit	1360
Fuqia e motorit në KW	65
Viti i prodhimit	2008
Ulëse	5
Ngjyra	Metalik i zi 20
Numri i Lejes së qarkullimit	MK 1468332
Regjistrimi	JO

Çmimi fillestar i makinës është 133.396,00 denarë.
Makina shitet në parim e parë – e blerë.

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:

Subjektet fizike: shtetas të aftë afarist të Republikës së Maqedonisë, shtetas të aftë afarist të huaj.

Subjekte juridike: të gjitha subjektet e vendit dhe të huaj juridik.

Fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:

Subjektet e interesuara të cilët marrin pjesë në ankandin publik duhet të plotësojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje, që është i mundshëm në ueb-faqen e Bankës popullore të Republikës së

Maqedonisë (<http://www.nbrm.mk>), ose ta marrin nga arkivi i Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë.

Fletëparaqitja nuk mund të ndërrohet, ndërsa secili ndërrim ose mos plotësim të të gjitha elementeve të saj mosdorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm paraqet bazë për diskualifikim të parashtruesit të saj nga pjesëmarrja në procedurë të ankandit publik.

Fletëparaqitjet parashtrohen me postë ose në arkivin e Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë deri më 4.09.2018.

Kushtet për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë:

Dëshmi për garanci të paguar për pjesëmarrje në ankandin publik.

Garanci për pjesëmarrje:

Garancia për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë është 10% e vlerës së secilës makinë veç e veç.

Garancia paguhet në llogarinë 100000000011103, deponent Banka popullore e Republikës së Maqedonisë, me shenjë "depozitë për ankand publik me gojë" (duhet patjetër të shënohet numri i shpalljes), si dhe numri rendor i automjetit për të cilin paguhet depozita.

Parashtruesve të fletëparaqitjeve të vonuara, të paplotësuara, dhe jo të rregullta dhe ofertuesve që nuk janë zgjedhur në ankandin publik u kthehet garancia në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, përveç ofertuesit më të volitshëm të cilët shuma e garancisë i përlogaritet në çmimin e përgjithshëm të shitjes.

Afati për pagesë të garancisë është më së voni tri ditë para ditës së mbajtjes së ankandit publik me gojë.

Afatet:

Ankandi publik me gojë do të mbahet më 5.09.2018 në lokalet e Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, në bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 1000 Shkup me fillim në ora 11:00.

Të gjithë personat e interesuar mund të vizitojnë makinat çdo ditë pune duke filluar nga 11.08.2018 në periudhë prej ora

11:00 deri në ora 13:00. Për të vizituar makinat të interesuarit mund të lajmërohen në numrin e telefonit 02/3108-106 ose 02/3108-416.

Ankandi publik me gojë:

Ankandi publik me gojë fillon me publikimin e çmimit fillestar të shitjes të makinës me numër rendor 1.

Secili ofertues para ankandit publik me gojë duhet të parashtrorë dëshmi për garancinë e paguar për ankandin publik me gojë, dokument për identifikim personal për subjektet fizike, dhe autorizime të vulosura për përfaqësuesit e subjekteve juridike.

Ankandi realizohet hap pas hapi, gjegjësisht me rritjen e çmimit çdo hap të ardhshëm për 10% nga çmimi fillestar i automjetit.

Pjesëmarrësi në ankand i cili ka ofruar çmimin më të lartë merr statusin ofertues më të volitshëm.

Pas përfundimit të procedurës për shitje të automjetit me numër rendor 1 kalohet në shitjen e automjetit me numër rendor 2. Procedura është e njëjtë sikurse për automjetin e mëparshëm.

Afati për pagesë të çmimit të shitblerjes është 30 ditë nga dita e lidhjes së Marrëveshjes për shitje.

Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk paguan mjetet brenda afatit të caktuar, do të llogaritet se patundshmëria nuk është shitur dhe garancia për pjesëmarrje në ankandin publik me gojë nuk do të kthehet.

Pas pagesës së realizuar të çmimit të shitblerjes në afatin e caktuar, Banka popullore lidhë marrëveshje e ofertuesin më të volitshëm.

Ofertuesi më i volitshëm obligohet që të paguajë të gjitha tatimet të cilat dalin nga obligimet në bazë të marrëveshjes së lidhur për shitje të automjetit.

Shpenzimet për procedurën e noterit bien në barrë të ofertuesit më të volitshëm.

Shkup 08.08.2018

Koha
E përditshme informative

**ÇMIMORE PËR PREZANTIM TË PAGUAR
PËR REFERENDUM**

Faqja e parë (color) 1 cm ²	2,5 €
Faqja e fundit (color) 1 cm ²	1,04 €
Faqja e brendshme (color) 1 cm ²	1,00 €
Faqja e brendshme (bardhë e zi) 1 cm ²	0,70 €

1/1 faqja e brendshme (bardhë e zi)	450 €
1/2 faqja e brendshme (bardhë e zi)	252 €
1/4 faqja e brendshme (bardhë e zi)	162 €
1/1 faqja e brendshme (color)	585 €
1/2 faqja e brendshme (color)	342 €
1/4 faqja e brendshme (color)	180 €

1/2 faqja e brendshme portret (bardhë e zi)	360 €
1/2 faqja e brendshme portret (color)	450 €

Shërbime speciale: - kërkesa e veçantë për pozicionim të reklamës e rrit çmimin për 25%.

Në çmim nuk është llogaritur TVSH-ja.

Dimensionet

1/1250 x 385 mm

1/2250 x 190 mm

1/4122 x 190 mm



Kësisoj, rruga regjionale Tetovë-Pirok-Gostivar është duke marrë haraçin. Kohëve të fundit kjo rrugë është bërë e rrezikshme dhe fatale për vozitësit. Pika më kritike e kësaj rruge ku ndodhin më shumë aksidente është fshati Reçicë dhe Pallçisht

RRUGËT REGJIONALE TË TMERRSHME PËR VOZITËSIT

RRUGËT E STËRNGARKUARA, MUNGON SIGURIA



trike të goditura, dëmtime të mureve të varrezave, shkelje të këmbësorëve, hyrje me veturë në dyqane, dëmtim të reklamave të pompës së benzinës... janë vetëm disa nga aksidentet që kanë ndodhur viteve të fundit në këtë rrugë. Në këtë rast, më shumë janë të rrezikuar banorët e fshatrave Reçicë e Madhe, Pallçisht, Kamjan, Siniçan, Bogovinë, Pirok, të cilët kanë shtëpitë e tyre përgjatë kësaj rruge. Rritja e aksidenteve është shënuar pikërisht pas asfaltimit të kësaj rruge me ç'rast është rritur edhe shpejtësia me të cilët vozitet në këtë rrugë.

Banorët nga ana tjetër theksojnë se ndjehen të pasigurt sidomos gjatë orëve të mbrëmjes, pasi pjesa dërmuese e aksidenteve ndodhin gjatë natës. "Kërkojmë që organet policore dhe pushtetet lokale të marrin masa që të krijojnë siguri në këtë rrugë, pasi bëhet fjalë për një gjatësi prej 2 kilometrave që përfshinë fshatin tonë", thonë banorët të kësaj zone. Policia e Tetovës pranon se në disa akse rrugore që janë në kategorinë e rrugëve regjionale mungojnë shenjat që ndikon në sigurinë e përgjithshme në komunikacionin rrugor.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 7 gusht - Rruga Tetovë-Pirok dhe rruga Tetovë-Jazhinçë tashmë vite me radhë janë kthyer në rrugë të tmerrshme për vozitësit. Pothuajse çdo ditë në këto rrugë regjionale regjistrohen aksidente. Arsytet më të shpeshta për numrin e madh të aksidenteve në këto rrugë janë mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet e rrugës, gjegjësisht vozitja e shpejtë, mos respektimi i sinjalistikës rrugore, stërnarkimi i rrugës për shkak të rritjes së fluksit të automjeteve që qarkullojnë në këtë rrugë, sidomos në muajt e verës, por edhe për shkak të dëmtimit të rrugës në shumë pjesë të sajë. Si rezultat, në këto rrugë regjionale janë regjistruar shumë dalje nga rruga, të cilat jo rrallë herë janë shoqëruar edhe me rrokullisjen e automjeteve, ndeshje, por ka pasur raste kur kanë pësuar edhe këmbësorët, çiklistët dhe motoçiklistët.

Përveç kësaj, aksidentet në këtë

periudhë kohore kanë ndodhur edhe për shkak të veprimeve jo të ndërgjegjshme, gjegjësisht të pahijshme, si parakalimet jo të rregullta, mos mbajtja e distancës dhe të ngjashme.

"Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, respektivisht Stacioni për siguri në trafik dhe rrugë, në gjashtë mujin e parë të këtij viti, në rrugën regjionale Tetovë-Pirok ka regjistruar 10 aksidente trafiku, nga të cilat 1 aksident me 1 person me lëndime të rënda trupore, 7 ak-

sidente trafiku me 10 persona me lëndime të lehta trupore, 2 aksidente trafiku vetëm me dëme materiale, kurse me viktima në njerëz nuk janë regjistruar aksidente trafiku", theksoi zëdhënësi i Policisë në Tetovë, Fatmir Rexhepi. Kësisoj, rruga regjionale Tetovë-Pirok-Gostivarë është duke marrë haraçin. Kohëve të fundit, kjo rrugë është bërë e rrezikshme dhe fatale për vozitësit. Pika më kritike e kësaj rruge ku ndodhin më shumë aksidente është fshati Reçicë dhe

Pallçishti. Banorët disa herë kanë kërkuar që të vendosen "policë të shtrirë" në rrugë me qëllim që të ngadalësohet shpejtësia e lëvizjes së automjeteve, por deri më tash autoritetet përgjegjëse nuk kanë dhënë leje për një gjë të tillë.

Kjo rrugë, e cila kalon përmes fshatrave të Tetovës dhe Komunës së Bogovinës, viteve të fundit është shndërruar në arenë aksidentesh, të cilët në shumë raste janë edhe të pazakonshme. Mure të thyera të shtëpive, shtylla elek-

Shkup angazhon 20 persona të papunë për punë komunale

Shkup, 7 gusht - Qyteti i Shkupit inkuadrohet në programin për punë të dobishme komunale ku do të angazhohen 20 persona të papunë me orar të shkurtuar pune në kuadër të projektit "Kontribute socio- arsimore përmes mbështetjes së kategorive të rrezikuara të qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit". Dhjetë persona të papunë do të angazhohen për periudhën prej nëntë muajsh si asistentë arsimor për personat me nevoja të posaçme arsimore në nëntë shkolla të mesme në Qytetin e Shkupit, ndërsa nga pesë do të angazhohen si asistentë personal për personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarë të personave të moshuar. Angazhimi është 20 orë në javë dhe personat për këtë do të marrin kompensim mujor prej nëntë mijë denarësh. Në kuadër të projektit ata do të kenë të paguar trajnimin. Afati i aplikimit është deri në 14 gusht. Qëllimi i projektit është avancimi i shërbimeve sociale në territorin e qytetit të Shkupit, me theks kategorinë e rrezikuar sociale të qytetarëve dhe nevojat e tyre të përditshme. Për personat e angazhuar përmes aftësimin profesional dhe përvojës në kuadër të projektit do të mundësohet inkuadrimi më i lehtë në tregun e punës. Projekti është në organizim të Qytetit të Shkupit, Agjencisë për punësim dhe Programit për zhvillim të Kombeve të bashkuara. (O.Xh)

Lufta për ajrin e pastër fitohet institucionalisht

Shkup, 7 gusht - Koalicioni Qytetar O2, i formuar nga disa shoqata dhe iniciativa qytetare, më shumë se një vit po përpiqet të bëjë zgjidhjen e problemeve ekologjike përmes rrugës institucionale.

Nevena Georgievska qytetare aktiviste si dhe pjesë e iniciativës "Ne jemi Karposh 4" për Civil Media ka deklaruar: "Para zgjedhjeve ne kemi arritur të nënshkruajmë një memorandum me të gjithë kandidatët dhe kryetarët e komunave në Shkup, me shpresën se do të jenë në gjendje të luftojnë për një qytet më të pastër, ajër më të pastër, tokë më të pastër... Megjithatë, ne nuk jemi të përqendruar vetëm në Shkup, por edhe në tërë Maqedoninë, për të gjitha problemet që lidhen me ndotjen e ajrit. Koalicioni O2 ishte aktiv edhe me veprimet kundër minierave, kurse ne jemi pjesë edhe e iniciativës "E dua Vodnon", tha Georgievska në kuadër të aktiviteteve të Koalicionit O2. Lidhur me reagimet e institucioneve dhe publikut ndaj mesazheve dhe përpjekjeve të Koalicionit O2, Georgievska tha se fillimisht ata kishin vëmendje të mjaftueshme, sidomos para zgjedhjeve, por



është e qartë se duhet të ketë presion të vazhdueshëm ndaj autoriteteve për të mbajtur vëmendjen e tyre edhe pas zgjedhjeve. "Ne ose ju si aktivist jemi të njohur me ligjet, procedurat dhe mundësitë, por kur do të vijë koha për opinionin publik përpiqemi që sa më shumë ti njoftojmë qytetarët si dhe të bëjmë përfshirjen e tyre në proces. Kur duhet të dëgjohet publiku duhet të jemi të zëshëm... Por, për shembull, kur flasim për ndotjen, ky problem është shumë kompleks dhe varet nga shumë

faktorë. Këtu ne duhet të fillojmë nga vetja jonë para se të kërkojmë fajin tek fqinjët apo fabrikat... duhet të shikojmë se çfarë kemi lënë pas, mjedis të pastër, nëse rreth meje ka ambient të shëndoshë njerëzor, gjelbërim, dhe si rrjedhim duhet të ndjekim situatën a kemi ndotje në ndërkohë", tha Georgievska. Ajo thotë se këmbëngulësia duhet vazhduar për ta arritur qëllimin, sepse, sipas saj, pas katër apo pesë vjetësh dikush do të gjejë mbështetje dhe nxitje për aktivitete të tjera. (R.B)

Çfarë fiton Serbia në shkëmbimin e territoreve?



Nga
Dr. Sabri KIÇMARI

Në hulumtim e sipër, për ta dekoduar strategjinë serbe për shkëmbimin e territoreve, një mik imi, shumë i angazhuar në proceset politike dhe shoqërore në Kosovë, më rekomandoi një studim interesant të Fondacionit për Shoqëri të Hapur në Serbi, me titull "Efektet ekonomike, demografike dhe sociale sipas skenarëve të ndryshëm për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Beogradit dhe Prishtinës". Autorë të këtij studimi janë Miladin Kovačević, Dusan Gavrilović, Dragan Popović, Milena B. Stevović, Ljiljana Sekulić dhe Katarina Stancić.

Në këtë studim autorët parashtrajnë efektet e mundshme të tri varianteve të rregullimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë: shkëmbimit të territoreve, zgjidhjes sipas Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 dhe gjendjes së status quo-s.

Duke analizuar në detale parashikimet demografike, sociale dhe ekonomike, autorët e studimit arrijnë në përfundimin se varianti i shkëmbimit të territoreve është më profitabel se sa Marrëveshja e Brukselit dhe ruajtja e status quo-s. Ata parashohin që katër komunat e Veriut (Mitrovica e Veriut, Zubin Potoku, Zveçani dhe Leposaviqi) të shkëmben me vetëm Preshevën, përdërisa Bujanocin dhe Medvegjen i konsiderojnë pjesë të panegociueshme në një proces shkëmbimi. Këtë e arsyetojnë me faktin se, sipas të dhënave të tyre, në Bujanoc ka vetëm një shumicë të thjeshtë shqiptare (rreth 53.4%), kurse në Medvegje shqiptarët përbëjnë vetëm 7.1%.

Në rast realizimi të këtij skenari katër komunat e Veriut të Kosovës do të integroheshin në sistemin politik, ekonomik dhe shoqëror të Serbisë, kurse Presheva në atë të Kosovës. Përmes një shkëmbimi të tillë të territorit, Serbia do të shtonte numrin për 12.000 banorë dhe do të rriste territorin e saj për 1000 km². Me këtë do të rritej BPV i Serbisë për 90 milionë euro në vit, gjë që në 30 vitet e ardhshme fitimi do të ishte për 2.7 miliardë euro.

Si rrjedhim do të rritej klima ekonomike dhe stabilizohej situata politike, gjë që do të sillte deri te rritja e rejtigut kreditor të shtet serb dhe lehtësimin e depërtimit të kapitalit të huaj në Serbi, borxhi i jashtëm do të zvogëlohej nga 24,1 miliardë euro në vitin 2017 në 14,8 miliardë euro në vitin 2030. Në kuadër të këtij varianti studiuesit serb e këshillojnë Qeverinë e Serbisë që të ketë kujdes për të mos lëshuar pe në lidhje me pronësinë mbi Kombinatin "Trepça", "Feronikel"-in dhe



termocentralin KEK në Obiliq, edhe pse janë të vetëdijshëm se "është e vështirë që të sigurohen 100 % të pronësisë së shtetit serb mbi to". Varianti i normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, sipas Marrëveshjes së Brukselit, të vitit 2013, sipas autorëve të këtij studimi, do të kishte efekte pozitive për Serbinë, sepse do të mundësohej Bashkësia e Komunave Serbe me një sistem autonomie dhe vetëqeverisjeje brenda territorit të Kosovës, ani që komunat veriore të Kosovës do të mbeteshin de facto jashtë sistemit ekonomik dhe politik të Serbisë. Ky variant do të sillte humbje buxhetit të shtetit serb për 47 milionë euro deri në vitin 2030 për të paguar Zyrën Serbe për Kosovën.

Autorët e këtij studimi konstatojnë se varianti i status quo-s është më i dëmshëm se sa dy variantet e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ata shkruajnë se në

rast të ruajtjes së status quo-s, pritet që numri i përgjithshëm i popullsisë do të bie në mënyrë drastike për 44% deri në vitin 2060 gjë që do të rezultonte me një balancë të re demografike në rajon.

Numri i banorëve të Serbisë pritet të ulet nga 7.095.381, sa ishin në vitin 2015, në 3.957.523 në vitin 2060. Koeficienti i të moshuarve do të rritet në mënyrë drastike, kurse fuqia punëtore do të zvogëlohet ndjeshëm. Në territorin e Veriut të Kosovës do të rrjedh një proces emigrimi i të rinjve dhe në këtë rajon do të qëndrojnë vetëm njerëz të moshuar, gjë që do të sjell deri te depopullimi drastik i rajonit. Humbjet për Zyrën Serbe për Kosovën në këtë rast do të ishin rreth 1.4 miliardë euro, do të zvogëloheshin ndjeshëm rezervat de vizore, investimet direkte dhe do të rritej ndjeshëm papunësia.

Bazuar në këto të dhëna këtij studimi, autorët konstatojnë se Serbisë i konvenon në rrafshin demografik, eko-

Në rast realizimi të shkëmbimit të territoreve, katër komunat e Veriut të Kosovës do të integroheshin në sistemin politik, ekonomik dhe shoqëror të Serbisë, kurse Presheva në atë të Kosovës. Përmes një shkëmbimi të tillë të territorit, Serbia do të shtonte numrin për 12.000 banorë dhe do të rriste territorin e saj për 1000 km². Me këtë do të rritej BPV i Serbisë për 90 milionë euro në vit



nomik, social dhe strategjik shkëmbimi i territoreve. Të dhëna e parashikimeve të studiuesve serb përputhen në plotëni me deklaratimet publike të presidentit serb se "në rast se nuk e zgjidhim tani çështjen e Kosovës do të detyrohemi më vonë të bisedojmë për Vranjë" dhe se "Serbia me marrëveshjen e re do të fitojë më shumë se sa ka shpresuar". Në fakt fjalitë e tilla pasqyrojnë drojë serbe par zhvillimet demografike në Serbi dhe ngutin e tyre për të përfunduar çështjen me shqiptarët gjatë kësaj faze të raporteve në rajon dhe Evropë, të cilat udhëheqja serbe i gjykon si të volitshme.

Por, cilat janë interesat e Kosovës? Cila është strategjia e Kosovës? Cili është varianti më profitabel për Kosovën? Institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës, legislative dhe ekzekutive, duhet të angazhojnë urgjentisht studiuesit në proces: të analizojnë paanshëm rezultatet e marrëveshjeve të deritanishme të Brukselit, të hulumtojnë të dhënat empirike dhe të parashikojnë zhvillimet e ardhshme demografike, ekonomike dhe sociale, të japin mendimin e tyre dhe propozimet konkrete mbi strategjinë dhe realizimin e interesave të vendit. Politika duhet kthyer kokën drejt studiuesve dhe shkencëtarëve, nëse dëshiron të mos futet në qorr-sokak. (Epoka e Re)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 7 gusht | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

LOJA ME ZJARRIN NË BALLKAN



Nga Jacob L. SHAPIRO

Javën e shkuar, një gazetë kosovare botoi një raport bombastik, duke pretenduar se SHBA-ja dhe Rusia kanë ranë dakord në samitin e Helsinkit, për një ndarje të mundshme të Kosovës, me synim zgjidhjen e mosmarrëveshjes së vazhdueshme mbi pavarësinë e Kosovës - një opsion që Uashingtoni e ka kundërshtuar në të kaluarën.

Sipas gazetës "Express", marrëveshja parashikon që Kosova t'i japë një pjesë të territorit të saj Serbisë, në këmbim të njohjes së pavarësisë së saj nga Beogradi - duke shkëmbyer në thelb tokën për paqe. Raporti gjithashtu sugjeronte, se kjo do t'i hapë rrugën Kosovës, e cila është pothuajse tërësisht etnikisht shqiptare, që të bëhet një provincë de fakto shqiptare.

Ministria e Jashtme e Rusisë, e cilësoi si qesharak raportin të premtën e kaluar, duke e cilësuar atë si "shumë të rrezikshëm" dhe një "dezinformim absolut". Megjithatë, ministri i Jashtëm i Serbisë u tha gazetarëve në Uashington pas përfundimit të takimeve 2-ditore me zyrtarët amerikanë, se për herë të parë në 30 vjet, Shtetet e Bashkuara ishin të gatshme për një kompromis mbi çështjen e Kosovës, dhe se kjo mund të përbëjë bazën për rivendosjen e marrëdhënieve më të afërta SHBA-Serbi. Të gjitha palët duket se po distancohen nga historia, por historia nuk po largohet. Skenari i ndarjes, është diskutuar si një rrugë e mundshme, që nga përpjekja e parë e Kosovës për shpalljen e pavarësisë në vitin 1991. Por ideja mbeti në letër, ndryshimi i kufijve është një çështje e ndërlikuar në Europë, dhe sidomos në Ballkan.

Para rënies së saj, Jugosllavia përbëhej nga gjashtë republika socialiste: Serbia, Bosnja Hercegovina, Kroacia, Sllovenia, Maqedonia dhe Mali i Zi. Kosova ishte një krahinë autonome brenda Serbisë. (Po kështu edhe Vojvodina - një nga arsyet se përse Serbia është aq kundërshtuese për pavarësinë e Kosovës). Si një provincë autonome, Kosova mund të shpallte teorisht pavarësinë pa ndryshuar kufijtë e saj. Kjo është një nga arsyet pse Kosova synoi pavarësinë, në



Nëse Kosova dhe Serbia fillojnë ndryshimin e kufijve, asgjë nuk e ndalon Shqipërinë të dëshirojë të ndryshojë kufijtë e saj me Maqedoninë, që ka një minoritet të madh etnik shqiptarësh, ose Kroacinë të ndryshojë kufijtë me Bosnjën, ku jeton një pakicë e konsiderueshme kroatësh etnikë. Për këtë arsye ndarja nuk ka ngjitur deri tani, jo vetëm për vendet e Ballkanit, por edhe për Kombet e Bashkuara, Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat së bashku kanë mbikëqyrur zhvillimin e rajonit në atë që është sot. Nëse ata bien dakord të ndryshojnë një kufi, atëherë mund të duhet të ndryshohen edhe të tjerët

vend të aneksimit nga Shqipëria - kjo e fundit do të shkaktonte shumë kundërshtime në të gjithë Europën.

Problemi me këtë qasje, është se ajo nuk llogarit faktin se ka zona të pakicave etnike, të përhapura nëpër kufijtë shtetërore në të gjithë rajonin. Ndarja është një opsion tërheqës, pasi do t'i lejonte të dyja palët të ruanin kontrollin mbi zonat e dominuara nga grupet e tyre etnike. Rreth 120 mijë serbë etnikë jetojnë ende në Kosovë, të përqendruar vetëm në kufirin serb në veri, ndërsa një popullsi e konsiderueshme etnike shqiptare jeton në Serbi. Prandaj, do të kishte kuptim që Serbia të merrte pjesë nga zonat me shumicë serbe etnike në Kosovë, dhe që Kosova të merrte pjesë nga zonat me shumicë shqiptare në Serbi.

Problemi është se kjo do të hapte kutinë e Pandorës. Nëse Kosova dhe Serbia fillojnë ndryshimin e kufijve, asgjë nuk e ndalon Shqipërinë të dëshirojë të ndryshojë kufijtë e saj me Maqedoninë, që ka një minoritet të madh etnik shqiptarësh, ose Kroacinë të ndryshojë kufijtë me Bosnjën, ku jeton një pakicë e konsiderueshme kroatësh etnikë. Për këtë arsye ndarja nuk

ka ngjitur deri tani, jo vetëm për vendet e Ballkanit, por edhe për Kombet e Bashkuara, Bashkimin Europian dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat së bashku kanë mbikëqyrur zhvillimin e rajonit në atë që është sot. Nëse ata bien dakord të ndryshojnë një kufi, atëherë mund të duhet të ndryshohen edhe të tjerët.

Në veçanti Bashkimi Evropian, është i kujdesshëm ndaj ndarjes, për shkak të precedentit të rrezikshëm që mund të vendoset në pjesë të tjera të bllokut (Katalonja është shembulli më i njohur, por jo i vetmi). Në vend të kësaj, këto institucione kanë nxitur një zgjidhje që i lë siç janë kufijtë aktualë - duke përdorur si një nxitje pranimin potencial në BE dhe NATO. Në fakt, Serbia filloi negociatat për anëtarësim në BE në vitin 2014 - por unioni nuk do ta lejojë atë të bashkohet, ndërsa çështja e Kosovës mbetet ende e pazgjidhur.

Ndërsa ka pasur disa përparime në bisedimet e Serbisë dhe Kosovës gjatë viteve të fundit, ato kanë qenë përgjithësisht të ngadalta. Në takimin e vetëm të zhvilluar muajin e kaluar, presidentët e Serbisë dhe Kosovës dukeshin më larg se kurrë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, tha javën e kaluar se bisedimet po

arrinin në pikën e tyre më të vështirë, dhe se shanset për arritjen e një marrëveshjeje ishin "minimale". Zërat rreth ndarjes së Kosovës janë shtuar, teksa negociatat duket se kanë arritur në një udhë pa krye, çka sugjeron që jo vetëm ndarja në tavolinë, por të paktën disa palë të përfshira e shohin atë si një mënyrë për të kapërcyer ngërçin aktual. Tani për tani, vetëm Serbia ka shprehur publikisht një qëndrim në favor të këtij opsioni.

Presidenti serb, sugjeroi javën e kaluar se ndarja përgjatë vijave etnike, mund të jetë një zgjidhje. Ndërkohë, presidenti i Kosovës ka qenë publikisht më i paqartë në lidhje me kundërshtimin e tij ndaj idesë, duke thënë se "s'do të ketë ndarje", edhe pse mediat lokale vazhdojnë të raportojnë se Kosova do të ushtrojë presion për rishikimin e kufijve. Përsa i përket SHBA-së dhe Rusisë, ato nuk kanë marrë qëndrime të forta.

Mediat kosovare pretendojnë se në një intervistë të datës 21 korrik në KTV, ambasadori i SHBA në Kosovë e mbështeti idenë e ndarjes. Por ai e ka hedhur poshtë këtë lloj interpretimi të komenteve të tij, edhe pse nuk e ka përfshuar ndarjen si një opsion, nëse Ko-

sova do ta ndërmerre këtë rrugë.

As Rusia nuk e ka përfshuar plotësisht këtë mundësi - megjithëse ka mohuar arritjen e një marrëveshjeje të tillë në Helsinki me SHBA-në. Moska theksoi se një zgjidhje do të duhej të vendoset midis Beogradit dhe Prishtinës, dhe se të dyja palët duhet të respektojnë çfarëdolloj marrëveshjeje që ato arrijnë, në kuadër të procesit të negociatave të ndërmjetësuar nga BE. Interesi kryesor i Rusisë nuk është ruajtja e paprekshmërisë territoriale të Serbisë, por më tepër pasja e marrëdhënieve të ngushta me Serbinë. Nëse Serbia mendon se njohja e pavarësisë së Kosovës, me ose pa ndarjen e saj, është në interesin e saj, Rusia ka gjasa të pajtohet me këtë qasje.

Ajo nuk dëshiron të rrezikojë të humbasë marrëdhëniet e saj me Serbinë, ashtu si Bashkimi Sovjetik që humbi dikur Jugosllavinë. Problemi për Rusinë, është se një marrëveshje Serbi-Kosovë, mund ta sjellë Serbinë më afër Perëndimit, por kjo mund të jetë tanimë e pashmangshme. Serbia ka natyrisht, ka një rrugë të gjatë përpara, dhe sipas fjalëve të Ministrisë së Jashtme ruse, shumë gjëra mund të ndryshojnë "në një rajon aq të komplikuar sa Ballkani". Megjithatë, interesat e palëve të përfshira duket se përputhen.

Serbia sheh një mundësi për t'u angazhuar si me SHBA-në, ashtu edhe Rusinë. Kosova e sheh si një mundësi për njohje.

Shtetet e Bashkuara dhe BE, mendojnë se mund të jenë në gjendje të sjellin në Perëndim më shumë vende të Ballkanit. Dhe Rusia ka pak interes të krijojë pengesa, nëse Beogradi dëshiron të ecë përpara. Rusia ka ende një ndikim të konsiderueshëm mbi Serbinë, dhe mund të përpiqet ta përdorë atë për të nxjerrë lëshime nga Perëndimi në çështjet që lidhen me Ukrainën ose sanksionet e perëndimit, por nuk ka gjasa të sabotojë një marrëveshje nëse arrihet një e tillë. Ndryshimi i kufijve në këtë pjesë të botës është një lojë me zjarrin, por zgjidhja e njërës prej mosmarrëveshjeve më të mëdha kufitare në kontinentin evropian mund t'ia vlejë marrjen parasysh të këtij rreziku.

Nëse gjërat marrin për keq, cili do vend i përfshirë mund të dëshiron ta kishte lënë zjarrin të qetë. Ndërkohë, presidenti i Kosovës duket se ka qenë i saktë: Faza tjetër e dialogut, do të jetë jashtëzakonisht e vështirë.

(Geopolitical Futures)



NË KËRKIM TË STREHIMIT

Në kufirin e Mianmarit dhe Bangladeshit, familjet e refugjatëve marrin strehim brenda gypave të betonit. Ata janë mysliman Rohingya, një grup njerëzish në Myanmar që vuajnë persekutim ekstrem. Deri në maj 2018, pothuajse një milion Rohingya kanë ikur nga Myanma për të kërkuar strehim në Bangladesh. Fotot janë realizuar nga National Geographic.





TURISTËT E SHËNDOSHË PO U MARRIN SHPIRTIN GOMERËVE TË SANTORINIT

Gomerët e ishullit grek të Santorinit po gjymtohen duke mbajtur në kurriz turistët e shëndoshë, që paguajnë për xhiro me gomar nëpër rrugët e ngushta të ishullit piktoresk. Nga maji deri në tetor, në Santorini vijnë rreth 1200 turistë në ditë. Gomerët përdoren për transport nëpër rrugica ku nuk kalojnë dot

makinat, por aktivistët e të drejtave të kafshëve thonë se obeziteti në rritje ka bërë që kafshëve t'u rritet ngarkesa dhe të shtohen dëmtimet e shtyllës kurri-zore. Banorët e zonës janë detyruar që të kryqëzojnë gomerë me mushka, që janë më të mëdha dhe mbajnë më shumë ngarkesë.



I paqartë fati i Asociacionit pas kalimit të afatit

Qeveria e Kosovës është duke prituri që draft-statuti për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, që dorëzohet në Bruksel nga ekipi menaxhues, të jetë i bazuar në Kushtetutën e Kosovës. Zyrtarët thonë se deri me tash nuk kanë pranuar ndonjë dokument final për statutin. Data 4 gusht ishte afati i fundit kur ekipi menaxhues i formuar për këtë çështje është dashur ta dërgojë në Bruksel draftin e parë të statutit të Asociacionit. "Pritjet tonë janë që ky draft të jetë i bazuar apo në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo është pritja jonë, dhe që ky proces që në fakt është një obligim i një marrëveshjeje ndërkombëtare që ka Kosova, të përfundojë sa më shpjet", tha për Radion Evropa e Lirë, Donjeta Gashi, zëdhënëse e Qeverisë së Kosovës. Nga ana tjetër, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë, konfirmon për Radion Evropa e Lirë se Statuti i Asociacionit të komunave me shumicë serbe, do të dorëzohet direkt në Bruksel nga ekipi për hartimin e draft-statutit. Në një përgjigje me shkrim nga Ministria thuhet se "raporti nga mbledhja e fundit e mbajtur nga ekipi menaxhues të hënën dorëzohet në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal [MAPL] dhe menjëherë posa të përkthehet do të dërgohet në kabinetin e kryeministrit". Në përgjigjen nga Ministria, theksohet po ashtu se herën e kaluar Zyra e Kryeministrit e ka kthyer raportin prapa për arsye se ka qenë vetëm në gjuhën serbe. Zyrtarët në ministri thotë se sapo të përkthehet do të procedohet në instancat përkatëse. Zëdhënësjë Gashi tha po ashtu se Qeveria e Kosovës ende nuk ka pranuar ndonjë dokument të ri nga grupi menaxhues për hartimin e statutit.

S'KA ZGJIDHJE TË LEHTË PËR KOSOVËN, I KEMI VETËM DY RRUGË PËRPARA

"Çka u mbetet serbëve të bëjnë në të ardhmen. Dy rrugë të mundshme. Një rrugë është që, pas më shumë se 1930 ditësh që Prishtina s'e ka përmbushur obligimin e saj, është që serbët të bëjnë atë vetë. Pak kush mund t'ua ndalojë këtë. Nëse do ta bënin serbët këtë, ekziston rreziku i veprimeve të njëanshme të cilat do t'i shërbenin Prishtinës për zgjidhje përfundimtare me veriun...", tha Vuçiqi

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq përmes një konference për media, ka thënë se zgjidhje të lehtë dhe të padhembshme për problemin e Kosovës nuk ka. Ai ka thënë se "është një nga çështjet kyçe që, për shkak të së ardhmes së Serbisë, të zgjidhim çështjen e Kosovës dhe Metohisë".

Vuçiqi shtoi se Serbia, që nga nënshkrimi i marrëveshjes së Brukselit, ka dhënë gjithçka nga vetja që të jetë partner i besueshëm jo vetëm i shqiptarëve, por edhe i bashkësisë ndërkombëtare. "Shqiptarët, me pajtim të heshur, rrjedhimisht pa kundërshtim të qartë të Bashkimit Evropian, nuk kanë zbatuar obligimet, e kjo është formimi i Asociacionit të komunave serb", tha Vuçiqi, raporton Koha.net.

"Do t'ju zbuloj edhe një gjë. Sipas Marrëveshjes së Brukselit, AKS-ja është ajo që propozon komandantin e policisë për veriun. AKS propozon katër kandidatë, nga të cilët Prishtina zgjedh njërin. Në këtë s'mund ta realizojmë sot sepse nuk e kemi AKS-në, dhe kështu komandantët e policisë na i cakton Prishtina", tha Vuçiqi. Sipas tij, Serbisë i kanë mbetur



NDRYSHIMI I KUFIJVE ËSHTË ANTI-KUSHTETUES

Ideja e përsëritur e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi për "korrigjim kufijsh", me të cilën nënkuptonte bashkimin e Luginës së Preshevës, bi në kundërshtim me Kushtetutën e vendit, konkretisht Nenin një të saj. Këtë gjë e ka pranuar edhe Presidenca e Kosovës përpos deklaratave të shefit të këtij institucioni. Nga Presidenca thuhet se që të arrihet një marrëveshje për bashkimin e Luginës, duhet ndryshuar Kushtetuta. Lidhur me

këtë çështje ka komentuar Këshilltari i Presidentit, Bekim Çollaku. "Është e qartë se ndryshimi i kufijve është në kundërshtim me Kushtetutën e vendit dhe nëse arrihet marrëveshja që Lugina e Preshevës t'i bashkohet Kosovës atëherë duhet ndryshuar Kushtetuta", ka thënë ai për mediat kosovare. Kjo tezë e hedhur së fundi duket se ka kënaqur disa serbët. Ministri i Jashtëm, Ivica Daçiç deklaroi se kjo mund të ishte një nisje e mirë drejt kompromisit.

vetëm dy rrugë të mundshme.

"Çka u mbetet serbëve të bëjnë në të ardhmen. Dy rrugë të mundshme. Një rrugë është që, pas më shumë se 1930 ditësh që Prishtina s'e ka përmbushur obligimin e saj, është që serbët të bëjnë atë vetë. Pak kush mund t'ua ndalojë këtë. Nëse do ta bënin serbët këtë, ekziston rreziku i veprimeve të njëanshme të cilat do t'i shërbenin Prishtinës për zgjidhje përfundimtare me ve-

riun. Për këtë arsye këshilla jonë për serbët në KeM është që të përcjellim me kujdes ngjarjet, të zgjedhim veprimet dhe të mos keqësojmë sigurinë e qytetarëve", tha ai.

Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zonave të mbrojtura në Kosovë. "Do t'i zgjidhim çështjen e pronësisë: dhe këtë në katër pika - pasuria personale private e serbëve, prona

e Kishës Ortodokse Serbe, prona në pronësi të subjekteve afariste që janë të regjistruara në Serbi jashtë KeM-së dhe prona në pronësi të subjekteve afariste që janë të regjistruara në KeM të Serbisë", tha ai, dhe shtoi: "Kjo çështje do të jetë një nga çështjet kyçe dhe më të rëndësishme". Pastaj Vuçiq pyeti: "A na duhet të gjejmë një zgjidhje, a do të sillte ndonjë zgjidhje të mira apo të vazhdojmë në këtë formë".



Kërkojmë punëtorë nga Kosova dhe Shqipëria

Ministri Federal i Shëndetësisë në Berlin, Jens Spahn (CDU) është shprehur për "Süddeutsche Zeitung" se vendet e punës nuk mungojnë për Gjermania ka nevojë për forcë punëtoare. Ai njoftoi hapjen e 13 mijë vendeve të lira të punës përmes kabinetit të tij dhe

tha se asnjë azil i të moshuarve në Gjermani nuk mund të funksionojë më pa ndihmën e fuqisë punëtoare të huaj. Mijëra punëtorë nga Shqipëria dhe Kosova janë futur në skemën e shtetit të Gjermanisë për t'u punësuar në disa spitaleve dhe shtëpitë e të mo-

shuarve. Berlini zyrtar ka njoftuar se kjo iniciative për vende të lira pune është bërë me arsyetimin se mungon fuqia punëtoare që përkujdesen për të moshuarit. Sipas tyre, ky problem nuk mund të zgjidhet thjesht vetëm me para.

Shtatori, muaji kyç për zgjidhjen e çështjes së Kosovës

Shtatori mund të jetë muaji kyç në zgjidhje e çështjes së Kosovës nga ana e Serbisë, shkruan e përditshmja serbe "Blic". Gazeta shkruan se presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, do të udhëtojë në Kinë pasi të vizitojë Kosovën, dhe më pas do të shkojë në New York, ku ai do të flasë në OKB. Teksa zgjidhja po hyn në fazën finale, presidenti serb do të hyjë në një

ofensivë diplomatike përgjatë muajit shtator, shkruan kjo e përditshme. Në fillim të shtatorit, së pari, siç është deklaruar, ai do të vijë në Kosovë ku do të bisedojë me serbët nga pjesa jugore e Kosovës. E para kësaj vizite, siç shkruan gazeta, Vuçiqi do të bisedojë së paku edhe njëherë me përfaqësuesit e tyre.

"Vuçiqi do t'u adresohet serbë-

ve në provincë, do t'i mbështes ata, do t'i dëgjojë problemet me të cilat përballen ata, do t'i pyes nëse kanë kërcënime të sigurisë dhe do të ofrojë ndihmë shtesë", citon gazeta "Blic" një burim nga autoritetet më të larta. Kah mes i shtatorit, presidenti do të udhëtojë në Kinë për një forum ekonomik. "Temat e ekonomisë do të jenë primare, por pasi që Kina

është një nga partnerët më të rëndësishëm ndërkombëtarë, kur të vijë puna tek Kosova, do të jetë me siguri një rast që Kina të konfirmojë mbështetjen e saj ndaj nesh në KS të OKB-së për këtë çështje", thotë bashkëbiseduesi i gazetës. Vuçiqi do të ketë pak ditë për të shpërndarë mesazhin e Kinës tek bashkëpunëtorët e tij, pasi që menjëherë do të udhëtojë

për në New York për një seancë të OKB-së.

"Presidenti do të qëndrojë në New York nga 24 deri më 28 shtator, ku do të flasë në një seancë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së", ka thënë burimi i gazetës serbe. Presidenti serb do të shfrytëzojë këtë vizitë edhe për kontakte me njerëz nga administrata e presidentit amerikan, Donald Trump.



Duterte arrin marrëveshje me muslimanët e Filipineve

Presidenti i Filipineve, Rodrigo Duterte, i dorëzoi Marrëveshjen Organike të Bansamoro (BOL) liderit të Frontit Çlirimtar Islam Moro (MILF), Al Hajj Murad Ebrahim, të cilin e dekretoi në fund të muajit korrik të këtij viti. Në ceremoninë e organizuar në pallatin presidencial Malacanang morën pjesë presidenti Duterte, anëtarë të kabinetit, përfaqësues të senatit dhe kuvendit të përfaqësuesve, zyrtarë të Zyrës për Këshillim të Procesit të Paqes, përfaqësues diplomatik në Manila, përfaqësues të Komisionit të Tranzicionit Bangsamoro (BTC) dhe të MILF. Duterte në fjalimin e tij të bërë pas dorëzimit të marrëveshjes Ebrahim-it, theksoi se para 10 ditëve e ka dekretuar ligjin. "Jemi duke përfunduar përlëshjen e dhjetëra viteve", tha Duterte. Ai duke falënderuar BTC dhe MILF për "përkushtimin e tyre të palëkundur" deri në procesin e dekretimit, tërhoqi vëmendjen në rëndësinë e unitetit gjatë procesit të paqes. "Po kërkoj nga vëllezërit e mi Moro, merrni pjesë në referendumin që do të organizohet, që të shfaqet dëshira juaj në aspektin absolut. Ejani të jemi bashkë në këtë proces", u shpreh presidenti i Filipineve. Ligji që parasheh autonomi gjithëpërfshirëse të muslimanëve Moro u dekretua nga Duterte më 25 korrik.

VENEZUELA, NJË VEND QË PO SHPËRTHEN NGA BRENDË

Raportimet për një atentat të supozuar kundër kryetarit të shtetit Nicolas Maduro shtrojnë shumë pyetje. Vetëm njëra prej tyre ka marrë që tani përgjigje: i vetmi që përfiton prej tyre është Maduro

Këtë herë qenë "ushtarët me fanella". Nicolas Maduro ka denoncuar të paktën njëzet grushte shteti dhe/ose atentate ndaj jetës së tij. Për ta dëmtuar asnjëri nuk e ka dëmtuar. Përkundrazi, nga çdo sulm real apo i imagjinuar, qoftë ai nga bota e jashtme "imperialiste" ose nga opozita "ekstremiste e djathtë" regjimi merr forcë të re. Incidenti më i fundit tregon se Venezuela jo vetëm që ndodhet në një krizë të rëndë politike dhe ekonomike, por edhe në një luftë informative. Sepse, nuk është e sigurtë që kryetari i shtetit Maduro të jetë sulmuar vërtet nga një dronë. Agjencisë së lajmeve AP zjarrfikës nga Caracasi i thanë se shkaku ishte shpërthimi i një cisterne gazi në një apartament.

Maduro shfrytëzon çdo incident të ri për të ndërmarrë një gjueti shtrigash ndaj opozitës, për fjalë vulgare kundër shteteve fqinje si Kolumbisë dhe jo së fundi për spastrime në radhët e veta dhe të ushtrisë. Dhe çdo incident i ri largon vëmendjen nga problemet gjithnjë e më shumë të padurueshme të Venezuelës.



BENZINA ËSHTË MË E LIRË SE UJI

Sulmi i supozuar u ndërmor gjatë paradës për 81 vjetorin e Gardës Kombëtare të Venezuelës tri ditë pasi Maduro pati shpallur një politikë të re për benzinën. Dhe vetëm një ditë pasi qeveria urdhëroi të numërohen automjetet në vend, të shoqëruar me deklaratën se vetëm pjesëmarrësit e numërimi do të merrnin edhe më tej benzinë me çmime të subvencionuara. Një mbushje serbatori në Venezuelë kushton më pak se një cent Euroje, por benzinën vendi me rezervat më të mëdha të naftës në botë, në masën më të madhe duhet ta importojë, sepse industria vendase ka kohë që është rënuar.

Po pak ditë më parë, Fondi Monetar Ndërkombëtar deklaroi se inflacioni sivjet në Venezuelë do të arrijë kuotën 1.000.000 = 1 milion për qind. Me një reformë monetare qeveria do të eliminojë që

këtë vit pesë zero të vlerës nominale të bolivarit.

FËMIJË QË VUAJNË NGA URIA

Krahas benzinës, në Venezuelë janë të subvencionuara edhe shumë gjëra të tjera - energjia, transporti i distancave të shkurtra, ushqimet, medikamentet. Por për të munguar mungojnë të gjitha, sepse vendi nuk i gjeneron këto burime në deviza, të cilat i duhen për importet. "Revolucioni bolivian" i ka paralizuar me sukses kapacitetet e prodhimit të Venezuelës. Të panumërta janë raportimet për të sëmurë të pafurnizuar në spitale të rrënuara, për fëmijë që vuajnë nga uria, për emigrantë të dëshpëruar.

Përpjekjet e regjimit për të ndërmarrë hapa kundër këtyre zhvillimeve jo vetëm që duken gjithnjë e më të hutuara, por edhe janë të tilla. Venezuela është rënuar kaq në themel, sa do t'i duhen dekada që vendi dikur më i pasur i Amerikës së Jugut të paktën t'i

afrohet standardit të jetesës së fqinjëve të tij. Këtu nuk bën dobi as liberalizimi i pjesshëm i kursit të këmbimit. Zor se mund të bëhet më e rrezikshme për një qeveri diçka tjetër më shumë se eliminimi i subvencioneve. Për këtë ka shembuj nga shtetet e tjera të Amerikës Latine dhe jo së fundi nga vetë Venezuela. Nicolas Maduro e di këtë, por zor se do të jetë në gjendje ta pengojë këtë. Regjimi i tij po e drejton Venezuelën me vendosmëri drejt humnerës. Pavarësisht se natyrisht ky nuk mund të jetë asnjë justifikim për atentat - për këtë as nuk ka shkak. Pas Maduros janë në gatishmëri shumë pasardhës e pasardhëse të gatshëm për të luftuar, të cilët nuk presin asgjë nga një ndërrim i regjimit, por që i kanë të gjitha arsyet për t'u frikësuar maksimalisht. Sinjalet flasin për shpërthim përbrenda: "socializmi i shekullit të 21-të" dikur do të pësojë kolaps e do të thërmohet. (DW)

NJË KOALICION KUNDËR REFUGJATËVE

Ministri i Jashtëm i Spanjës, Borell, ka kërkuar përballë vërshimit të refugjatëve drejt vendit të tij solidaritet më të madh evropian

Po të mos duan të japin mbështetje të gjitha shtetet në BE, atëherë duhet të prijë "një koalicion i vogël shtetesh rreth Gjermanisë, Francës dhe Spanjës". Kështu është shprehur Josep Borell në një intervistë që i ka dhënë numrit të së martës të gazetës gjermane "Handelsblatt". Ministri i Jashtëm spanjoll lëvdoi politikën ndaj refugjatëve të Kancelares Federale Angela Merkel. Borrelli përmendi shprehimisht hapjen e kufijve nga

Merkeli në vitin 2015. "Për mua, Kancelarja Federale thjesht shpëtoi nderin e Evropës", tha politikan spanjoll.

Në lidhje me grupin pararojë që synon ai në BE, Borell tha se ai duhet të kundërshtojë me zgjidhje konstruktive politikën e frikës, të cilën e praktikojnë aktualisht qeveritë populiste të djathta. Në këtë kuadër duhet të ketë edhe nxitje për vendet e origjinës së emigrantëve, që t'i ripranojnë ata. Pro-

pozimi i Borellit është që për çdo imigrant të riatdhesuar, shtetet evropiane mund të pranojnë një emigrant legal, të cilin ta kualifikojnë. Ministri i Jashtëm spanjoll foli për një "lloj Erasmusi evropiano-afrikan", duke iu referuar programit me të njëjtin emër të studentëve. Por pas kualifikimit, njerëzit duhet të kthehen sërish në shtetin e tyre të origjinës dhe t'ia vënë në dispozicion dijen e tyre ekonomisë vendase. Një marrëve-



shje të kësaj natyre Spanja ka lidhur me Marokun dhe sipas Borellit nuk ka pasur probleme me riatdhesime atje.

Partitë e mëdha në Spanjë, me përjashtim të Podemos pajtohen në mendimin se numri më i madh i afrikanëve që vjen aktualisht në Spanjë përmes "itinerarit të Ma-


grebit", nuk janë njerëz në hall. Edhe statistikat e Zyrës së Imigrimit dëshmojnë se thuasj të gjithë emigrantët e rinj janë nga shtresa e mesme dhe ëndërojnë për mirëqenie, karriera si muzikantë ose futbollistë. Shumë ekspertë janë të mendimit se ata do të ndodhen në një rrugë pa krye në Evropë.

Kush ishte

Fahredin GUNGA?

Fahredin Gunga lindi në Mitrovicë më 1936. Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në vendlindje, kurse fakultetin filozofik, grupin e albanologjise, në Beograd. Ai ishte njëri nga poetët më të shquar të poezisë bashkëkohore shqiptare, të brezit që u shfaq nga fundi i viteve të '50-ta dhe brenda viteve të '60-ta. Brezi të cilit i takonte poeti Fahredin Gunga, ishte i përbërë nga Azem Shkreli, Ismail Kadare, Rrahman Dedaj, Dritëro Agolli, Din Mehmeti, Fatos Arapi, Ali Podrimja, Adem Gajtani, Hivzi Sylejmani e të tjerë.

Gunga e ka nisur vargimin poetikë që nga libri i parë me poezi "Pëshpëritjet e mëngjesit" (1961), duke i mbetur besnik deri te librat e fundit "Mallkimet zgjuara" dhe "Kepi i shpresës së mirë" të viteve të 80-ta.



FAHREDIN GUNGA

Rendja e gjatë pas ëndrrës

1.
E, tani, shkëmbët, po shkel nëpër hijen
e bjeshkës së nëmave, pranë reve të etura,
nën mjegullën e nëmët, nga kohë e ime e thinjur
nga brymat e mërive të gëlltitura, nga etjet
e moteve i tharë, i shkalë nga gjaku i lëndtë,...
po ec, i karmët, në rrëzë të bjeshkës së nëmave,
i nëmët, nëpër tokën e nëmët, të nëmët e të përnëmët,
i mbështjell me re motesh i kallur, nëpër vrere
të vrerta i grerë e gërryhem, e thuhem, me mëri
të ngjallur në gjinj, me zjarmi motesh i thëlluar,
me gjak të shpërgjakur që aorteve më vrujon,
po zbres, i përvalë, i përvëluar, në ëndërr të përendërrt,
dhe, nëpër damarë më oshëtin, e më mërmërin, ajo
klithmë e shkalëryer e motit, që ma vret dhembën
e lurtë, të nëmët e të gjëmët, me do rreze të një dielli
të përhenët, të flakëshuar, të atij dielli që edhe sytë
vetes ia verbëron, ku shpërmendet duke rendur
nëpër teh të kohës e të shorteve, që mbi kokë, nëma
si vezullime shpate më rri, e më ndrydh nëpër rrashtë,
po tatëpjetem, i nëmët e i përnëmët, gjakngrirë,
dhe fjetur, duke u shtrezuar në shtrezimet e tokës
së nëmët të nëmët e të përnëmët që shtriret
sa gjërë aq edhe gjatë rrëzë bjeshkës së nëmave
në ëndërrën e përendërrt, e, nëpër aorte më oshëtin,
e më ulqërin, një klithmë e shkallitur e kohës
që më grish, e nuk më flet, dhe, pres e pres, me net
e me ditë, dhe, i rri përballë erës së mëritur
të moteve, i djerrë nga agulltitë e shekujve, i shkëmbët
i shkabëruar, i nëmët rrëzë bjeshkës së nëmave,
i kallur nga ëndërra e përendërrt që më gërryen,
e shortesh më thyen, e më thëllon me vrere të vrerta
në eshtra, nën rrashtë të lashtëritur, në sy dritëfikur,
e, ku do të rend, më pyesin eshtrat e llavur,
të cilat m'i kanë mbështjellë shortet me nëma,
e dhembja e trollet më dergj, e shpresë të shpërshpresta
dergjon, e, çdo të gjesh në tokën e nëmët, të nëmët
e të përnëmët, kur zjarmi e ëndrave ngrin, e cegmë
e dhembës gjëllin duke brymosur nëmë, e shpresa
shpresës udhët ia ngatërron, e rend duke endur, endës
i ëndrave, me ëndërrën e përendërrt të mbërthyer,
të griluar, në gjinj të shekullit të shpërshkullt,
dhe, më pyesin eshtrat e gjëllitur nga nëmat e nëmëta

në tokën e nëmët, të nëmët e të përnëmët, në cilin
kep, vallë, shpresërin, e kepëritur, shpresa e përshprestë,
ajo shpresë e endur shekull më shekull, e përgjumët.

PËRRALLA E RE PËR
PROMETEUN
DHE SHTEGTIMIN E TIJ

1.
Pas prehjes në kilometrin Zero Zero-
të duket vetja se je Promete i zgjidhur
e, të hapen shumë rrugë përpara-si bota
me udhëkryqe, hejzime dhe kryqëzime

zembrën e ke det
e duart vatër të vjetër zjarresh

dhe,
nuk ec më vetëm në një diametër
se: botën mendon duhet ta lidhësh me lulak
i betuar në bebëzat e përroit në sytë e ferrishtes
për ta kallur detin e zemrës-

për t ja shuar Etjen vatrave të vjetra të duarve
që bartën në shekuj e mote: diell e hënë, dete e qiej
e i gatuan plisat e tokës për miq e dashamirë
e i latuan shkëmbinjtë me fjalë e dashuri-vetëm
për ta kallur detin e zemrës-

dhe,
nuk ec më vetëm në një diametër
se: botën mendon duhet ta lidhësh me lulak
I çliruar krejtësisht nga prangat e Mallkimit

Pas prehjes në kilometrin Zero Zero
bota ec e ec në shtegun e vet
nëpër përralla e ëndërra e ëndërralla

hapi yt ngec e ngec
nëpër udhëkryqe, hejzime e kryqëzime
se kurrjë më, e sheh, nuk fitohet me përralla
pa palla

2.
dhe, pyetesh
a e ke gjetur rrugën tënde të vërtetë
në atë kaçitjen prej ferrishte

me zemrën det
e duart vatër të vjetër zjarresh
me fjalën e dashurisë nën buzë e thonj-

atë rrugë
në të cilën do t i gjesh pjesët e tua
kokën tënde të gjuajtur kushediku-në bredhje,
të ndërsyer nëpër përralla e ëndërra e ëndërralla

e,
të duket vetja se je Promete i zgjidhur
nga prangat e mallkimit që i barte në Shekullin tënd
atëbotë,

e, don të luash Lojën e re në shtegtimin tënd
lojë loje
e luhet ashtu si është luajtur prore
këmbë pas këmbë-pa kërcime
me hapa të njëjtë: në udhëkryqe, në hejzime e në
kryqëzime

Pas prehjes në kilometrin Zero Zero
kurrjë më, e sheh, nuk fitohet me përralla
pa palla

loje loje.


RRËFIMI

Pse më shikon si të huejin? A nuk më njeh?
Sëbashku a si vorrosëm tifusarët e natës
dhe mëngjezet buzëkuqe bashkë me ta?
E hapa zemrën dhe rafal të ri për këngë
ia derdha syve të tokës naive, tokës llahusë—
tokës që era gjak kaherë nuk po i vjen.
Më thuej, pra, o vlla i im i dashtun—
vlla i djersës sime, i dallëndysheve të mija—
pse më këqyr si të huejin? A nuk më njeh
ende?

RIBOTIM I LIBRIT MË TË MIRË EKZISTUES

KURANI JEP KUPTIMIN E JETËS

Lexuesit dhe besimtarët shqiptarë kanë në duar shqipërimin më të plotë, më të kuptueshëm gjer më sot të kuranit. Kemi të bëjmë me një kryevepër filologjike të klasit të parë të shqipes, që fuqizon, lehtëson, konkretizon komunikimin e mesazhit të Allahut te shqiptarët si te të gjithë popujt e tjerë.



Nga Rexhep Torte

Doli nga shtypi botimi i 14 i Kuranit botuar nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam. Ky botim u realizua me kontributin e Ministrisë së Vakëfeve dhe Çështjeve Islame në shtetin e Kuvajtit, në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Fetare „Udha e Besimtarëve” –Tiranë, i shtypur në shtypshkronjën „Mileniumi i ri”.

Për përgatitjen e këtij libri të shenjtë u angazhua Këshilli botues i përbërë nga Dr.Ramiz Zekaj kryetar, dhe anëtarët Prof. dr.Shefik Osmani, Prof. as.dr.Arian Kadiu, Prof. dr.Hysni Myziri, Esat Miftari, Bedri Telegrafi, Alban Kodra, Eris Koliqi, Bledar Komina, Eduart Thartori.

Në hyrjen dhe fjalët e botuesit thuhet se Kurani është Libri i fundit që erdhi nga Zoti nëpërmes Profetit Muhamed, i cili ishte ndër lidhës që kumtonte atë që dëgjonin nga meleku Xhebrail. Përmbytja e Kuranit është e veçantë për nga struktura, e pakrahueshme për nga mënyra si janë të sistemuara fjalët nga brendia e të cilave gufon melodija nga struktura e vetë fjalëve. Kur fillojmë të mendojmë t'i shqyrtojmë dhe ti


analizojmë fjalët e tij, na shfaqen thesaret e domethëniesve, njohurive dhe mendimeve për të cilat nevoiten vëllime të tëra për ti shpjeguar. Lexuesi mbetet i mahnitur nga mendimi Kuranor, që gjithnjë synon drejt monoteizmit absolute. Kurani është një Libër Hynor ku shpirti fluturon nga te dojë brenda hapësirës së tij, nga filozofia tek e drejta, nga normat fetare tek ato civile, nga rregullat e përditshmërisë tek kronikat historike të njerëzimit, madje edhe tek etapat e zhvillimit të embrionit në mitrën e nënës. Kurani që prej 14 shekujve i ka ofruar dhe i ka dhënë gjithnjë njerëzimit arritjet skajore të mendimit teologjike shkencor dhe ka çuar drejt fakteve të pakontestueshme. Kjo krijon ndjesinë dhe plotëson bindjen se Kurani ka ardhur për të thënë fjalën e fundit për çdo gjë.

Kurani nuk mjaftohet me një popull të caktuar, përkundrazi i drejtohet tërë njerëzimit. Ai ka një lidhje direkte me gjuhën klasike arabe, përkthimi i tij në gjuhën tjetër bëhet i vështirë dhe më mirë është të flitet për një përkthim interpretues të tij. Botimi kryesisht mbështetet në përkthimin e kryer nga

Prof.Hasan I. Nahit në Kosovë, por përkthimi i tij është përmirësuar nga ana gjuhësore dhe stili e paraqitja. Ky është botim i ri dhe i plotë i Kuranit bashkë me kuptimet e tij në gjuhën shqipe. Ky botim u përgjigjet më së miri standarteve filologjike në nivele të kënaqshme. Kur lexohet përkthimi i tij në gjuhën shqipe, mendja fillon të shqyrtojë, analizojë dhe zbulojë gjëra të reja duke arritur te bindja më e madhe, sepse kështu e ka lumturuar Allahu që krijoi gjuhën dhe që i din fshehtësitë e saj. Ndërmjetësia për të shpjeguar fjalën e Zotit është e vështirë dhe kërkon cilësi intelektuale nga më të lartat, për të kuptuar shpirtërisht dhe fizikisht mesazhin hyjnor. Lexuesit dhe besimtarët shqiptarë kanë në duar shqipërimin më të plotë, më të kuptueshëm gjer më sot të kuranit. Kemi të bëjmë me një kryevepër filologjike të klasit të parë të shqipes, që fuqizon, lehtëson, konkretizon komunikimin e mesazhit të Allahut te shqiptarët si te të gjithë popujt e tjerë.

Kurani –Libri i Shenjtë i zbriti profetit të fundit, Hazretit Muhammed me qëllimin madhor për t'ua kumtuar tërë njerëzve pa përja-

shtim. Kurani nuk është shpallur në formën e një çasti më momental, por në formë të një procesi unikal të pa shembullt që ka zbritur 23 vjet. Sipas Kuranit, Allahu është Zot i vetëm i gjithëfuqishëm, absolut, i mirë dhe i drejtë, i mëshirshëm, që e ka krijuar gjithësinë dhe njeriun e ka pajisur me mendje për ta dalluar të vërtetën nga gënjeshtria, të mirën nga e keqja, të drejtën nga e padrejta, autentiken nga e rrema. Kurani u drejtohet të gjithëve pakufizim, si besimtarit të thjeshtë, ashtu edhe dijetarit erudite, të tëra nivelet kuptimore konvertohen dhe shkrihen në një. Kurani përshkak të frymës dhe porosive hynore në thelb u drejtohet tërë popujve, kulturave, qytetërimeve, që përmbledh frymën e të gjitha feve monoteiste për arsye të njëshmërisë së patjetërsueshme të Allahut të Madh dhe të profetëve pararendës gjer te profeti Muhamed. Ky dimension gjeografik dhe kohor, sa hynor aq edhe njerëzor i Kuranit, vjen në gjuhën shqipe për tu bërë pronë e çdo lexuesi të etur për të kuptuar dhe ndier Fjalën e Zotit, thuhet në parathënien dhe fjalën e botuesit të këtij Libri të Shenjtë.



Haveli, Michael Zantovsky

Biografia e Vaclav Havelit, shkruar nga Michael Zantovsky, është gëzim dhe frymëzim. E ngrohtë, me humor, me mprehtësi, ajo tregon historinë e jetës së një prej politikanëve, shkrimtarëve dhe studiuesve më të rëndësishëm të kohës sonë... Michael Zantovsky i ka bërë mikut të vet dhuratën e fundit duke shkruar jo një jetëshkrim shenjtoreësh, por një jetëshkrim të mrekullueshëm me plot ngjyra.

"Biografia e Vaclav Havelit, shkruar nga Michael Zantovsky, është gëzim dhe frymëzim. E ngrohtë, me humor, me mprehtësi, ajo tregon historinë e jetës së një prej politikanëve, shkrimtarëve dhe studiuesve më të rëndësishëm të kohës sonë... Michael Zantovsky i ka bërë mikut të vet dhuratën e fundit duke shkruar jo një jetëshkrim shenjtoreësh, por një jetëshkrim të mrekullueshëm me plot ngjyra, që nuk ka të krahasuar." (William Shawcross)

"Vaclav Haveli është një nga udhëheqësit e shquar, moral dhe politik, të kohës sonë dhe Michael Zantovsky ka shkruar biografinë e tij përfundimtare. E bukur dhe emocionuese, ajo na jep madhështinë e tij. Bazar mbi një miqësi të gjatë dhe të ngushtë... ky rrëfim thellësisht personal është edhe frymëzues, edhe plot me mësim për kohën tonë." (Walter Isaacson)

"Haveli ishte një nga burrat më të rëndësishëm të kohës së vet, intelektual që iu nxirrte telashe – një njeri jo konformist, i vendosur për të jetuar me të vërtetën, që vinte shpesh në pikëpyetje sistemin, bashkatdhetarët e tij dhe veten e vet. Askush nuk është më i përshtatshëm se sa Michael Zantovsky për të përshkruar, interpretuar dhe analizuar këtë gjigant moral. Biografia e Havelit është shkruar nga Michael Zantovsky me një kuptim të madh, me çiltërsi dhe dashuri dhe na jep analizën e një eksperimenti jo vetëm për politikën, por edhe për pjesët teatrale të Havelit." (Madeleine Albright)

Ligjerimi feminist te Kadare, Irena Myzeqari

Tërë vëllimi "Ligjerimi feminist te Kadare" i Irena Myzeqarit përvijon një mozaik që jo pak herë pritet të riformohet, pikërisht sa herë përftohet si i tillë. Kjo prijje lind nga fakti se brendia e analizave dhe trajtesave e mban me vështirësi gjerësinë dhe thellësinë e objektit të studiuar, sepse për çdonjërin nga çështjet e trajtuara mund të përvijohen dhe përmasa të tjerë më të gjera.

Kjo dhe për faktin se vepra letrare e Ismail Kadaresë ka përfutuar statusin e një prej referencave kryesore të koncepteve të rëndësishme historike dhe kul-

turore në Shqipëri. Për shkak të dimensioneve dhe origjinalitetit që mbart vepra e tij, ajo ka qenë shpeshherë terren në të cilën janë zhvilluar një sërë debatesh teorike, jo vetëm të natyrës letrare, por edhe qasjeve të tjera shkencore.

Mund të përmendim këtu koncepte të tilla si nacionalizmi, tjetri, hapësirat, mitet, identitetet etj.

Është kjo arsyeja që analiza e veprës së Irena Myzeqarit ndihmon në një farë mënyre, sado që në formë të përthyer artistikisht, të mund të bëhet radiografia e

shkallës së emancipimit të shoqërisë shqiptare, parë në evolucionin e saj.

Libri është i vetëmjaftueshëm në komunikimin e leximit, pjesët qëndrojnë në raporte varësie dhe bashkëmarrëdhënieje, përmes formash të veçanta të vlerësimit të dukurive. Në këto raporte bashkëmarrëdhënieje, përparësi nuk merr përshkrimi i dukurive, por domethënia, kuptimësia e thelbit të veprës së Kadaresë në raport me identitetin e femrës, duke krijuar një pjesë integrale të shqetësimit të tij për drejtësinë sociale.




Të qëndrosh në shtëpi me fëmijët, më e vështirë se të shkosh në punë



Sipas një studimi të ri, qëndrimi në shtëpi me fëmijët i prindërve të rinj, është më i vështirë se sa të shkosh në punë. Në këtë studim, për prindërit që bëhen me fëmijë për herë të parë, janë renditur gjërat që ata do të kufizohen të bëjnë. Kështu, nëse rri në shtëpi me fëmijën, do të keni 22% më pak shanse për të mbaruar filxhanin tuaj të çajit, 33% më pak të hani ushqimet tuaja të preferuara, 19% shanse më pak për të parë tele-

vizor etj. Pas fëmijës së tyre të parë, vetëm gjysma e prindërve të rinj besojnë se fillimi i një familje është eksperiencë perfekte, ndërsa një pjesë tjetër më e vogël besojnë ende se një fëmijë afron më tepër partnerët. Megjithatë, përveç rezultatit të këtij studimi, prindërit do të ndjejnë për herë të parë dashurinë e pakushtëzuar të fëmijës së tyre, si dhe ndjesinë e lëkurës së të porsalindurve, që është aroma më e mirë në botë.

Si ndikon në shëndet muzika e Mozartit



Mes muzikës së Mozartit dhe shëndetit të njeriut, ekziston një lidhje. Kjo është vërtetuar nga mjekët e Spitalit Mbretëror për Sëmundjet e Fëmijëve, në Edinburg. Ata kanë zbuluar se dëgjimi i Mozartit ndikon tek fëmijët. Këta të fundit kanë një rënie të aktivitetit epileptik në tru në momentin që janë duke dëgjuar muzikën e kompozitorit austriak. Studimet dolën në konkluzionin se fëmijët e moshës 2 vjeç deri në 18 vjeç që dëgjojnë Mozartin,

kanë tendencë për të reduktuar rrezikun e goditjeve epileptike në tru. 45 fëmijë u vendosën që të dëgjonin 5 minuta muzikën e Mozart dhe aktiviteti i trurit të tyre u mat. Rezultatet treguan reduktim të ndjeshëm në frekuencën e shkarkimeve epileptike në tru gjatë kësaj kohe. Megjithatë nuk është e qartë se si muzika ka një efekt të tillë. Një teori është se muzika e Mozart ka një model unik të ritmit që ndikon në aktivitetin e trurit.

GRATË SHQIPTARE ME NIKOQIRET NË EUROPË, BURRAT RRINË E KUVENDOJNË!



Ato që kryesojnë janë natyrisht femrat shqiptare, që shpenzojnë 29 orë në javë për t'u marrë me punë shtëpie e gati, të ndjekura nga rumunet me 23 orë dhe maltezet me 22 orë. Femrat e rajonit shpenzojnë shumë më pak kohë se tek ne (maqedonaset 18 orë, malazezet dhe serbët 19 orë)

Gratë shqiptare janë me nikoqiret e Europës, pasi rezultojnë se shpenzojnë më shumë kohë se gjithë shtetet e tjera për të gatuar dhe për të bërë punë shtëpie. Ndonëse pas viteve '90 lehtësitë janë shtuar si në kryerjen e punëve të shtëpisë ashtu dhe gatimin, sërisht ne vijojmë të humbim më shumë kohë, ndoshta për shkak të traditës, por edhe kursimit, kur vjen fjala te gatimi.

Sipas një sondazhi të Komisionit Europian për cilësinë e jetës në vendet e Bashkimit Europian dhe ato kandidatë, rezultojnë se pyetjes "Mesatarisht sa orë në javë shpenzoni për të gatuar dhe për të bërë punë shtëpie jashtë punës së paguar?", të anketuarit shqiptarë i janë përgjigjur 25 orë, që është më e larta në Europë, për shkak të orëve të gjata të deklaruara nga gratë.

Pas shqiptarëve, më shumë kohë për punë shtëpie shpenzojnë rumunët (21 orë) dhe turqit (19 orë), ndërsa më pak danezët (9 orë), finlandezët (11) dhe suedezët (11).

Ato që kryesojnë janë natyrisht

femrat shqiptare, që shpenzojnë 29 orë në javë për t'u marrë me punë shtëpie e gati, të ndjekura nga rumunet me 23 orë dhe maltezet me 22 orë. Femrat e rajonit shpenzojnë shumë më pak kohë se tek ne (maqedonaset 18 orë, malazezet dhe serbët 19 orë).

Nëse i referohemi burrave shqiptarë, ata nuk kanë kohë për të humbur duke u marrë me gatim e punë shtëpie. Meshkujt shqiptarë kanë raportuar se shpenzojnë rreth 12 orë në javë, që është e krahasueshme me mesataren e Europës dhe me vendet e tjera të rajonit dhe shumë më e ultë se koha që shpenzojnë partneret e tyre. Ndërsa më punëtorët janë burrat rumunë, që shpenzojnë 20 orë në javë, vetëm 2 orë më pak se femrat rumune.

Në Shqipëri, grupmoshat nga 18-24 vjeç shpenzojnë 15 orë për të gatuar e punë shtëpie; 25-34 vjeç harxhojnë 25 orë; 35-49 vjeç shpenzojnë 29 orë; 50-65 vjeç 27 orë dhe mbi këtë moshë 22 orë. Për të gjitha grupmoshat, me përjashtim të asaj mbi 65 vjeç, ku kryesojnë rumunët,

numri i orëve është më i larti në Europë.

Vetëm në familjet shqiptare me të ardhura të larta, numri i orëve të raportuara në javë për të gatuar e punë shtëpie ulet në 19, ndërsa te familjet e varfra gratë shpenzojnë nga 22-29 orë në javë.

Raporti "Cilësia e jetës - publikimi i të dhënave për të nxitur politika më të mira", është hartuar nga Komisioni Europian dhe në të për herë të parë janë përfshirë edhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Raporti i studimit tregon rezultatet në tre fusha kryesore: cilësia e jetës, cilësia e shoqërisë dhe cilësia e shërbimeve publike.

Anketa Evropiane e Cilësisë së Jetës është një studim unik pan-evropian që shqyrton kushtet e jetës së qytetarëve evropian në lidhje me mirëqenien individuale dhe cilësinë e shoqërisë dhe shërbimeve publike. Ai përfshin tema të tilla si shëndetësia, strehimi, ekuilibri i familjes dhe i punës dhe i jetës, si dhe besimi, pjesëmarrja në shoqëri, përjashtimi social dhe tensionet shoqërore.

Qyteza italiane shet shtëpi për 1 euro

Këshilli i qytetit italian San Pietro Pati vendosi të shesë shtëpi të vjetra të braktisura me një çmim prej një euro, për të ringjallur këtë vend të vendosur në rajonin kodrinor të Sicilisë. Për shkak të migrimit dhe plakjes, qyteti humbi një pjesë të madhe të popullsisë, kështu që ishte e nevojshme të ndërmerren masa urgjente dhe hapa për të parandaluar zhdukjen e këtij qyteti.

Ata që zgjedhin të blejnë një shtëpi do të duhet të rindërtojnë duke përdorur gurin tradicional, dru dhe terrakote për çati, dhe ndoshta të punësojnë muratorë lokalë.

Ajo që e bën këtë vend tërheqës është vetëm 15 minuta larg plazhit dhe në fund të Parkut Kombëtar të Nebrodit, zonave të mbrojtura të liqeneve malore dhe pyjeve. Administrata e

qytetit tani do të vlerësojë se sa shtëpi do të ofrohen për shitje dhe do të kontaktojë pronarët. Pritet që shtëpitë e para do të jenë në shitje vitin e ardhshëm. Qytetarët e huaj janë gjithashtu të mirëpritur.

San Pietro Pati kishte 4000 banorë 20 vjet më parë, ndërsa sot numri është zvogëluar në 3000. Qyteti i takon rajonit ku ka një përqindje të lartë të të papunëve.



Gjatë 16 viteve të fundit, Italinë e kanë braktisur 1.8 milion njerëz,

gjysma prej të cilëve janë të rinj në mes të 15 dhe 34-vjeç.

Pas TNS-së dhe Sheriff Tiraspolit, për djemtë e trajnerit Qatip Osmani kjo përballje është një sfidë e madhe, por ata nuk ndejnë presion pasi nuk kanë se çfarë të humbin, por munden vetëm të fitojnë. E themi këtë pasi edhe në rast të eliminimit nga Liga e kampionëve, Shkëndija do të luajë në 'play-off' të Liga Evropës, për herë të dytë pasi më herët ata u eliminuan nga skuadra belge Gent

NË "RED BULL ARENA" SONTE SHKËNDIJA SFIDON SALLZBURGUN KUQEZINJTË NUK KANË SE ÇFARË TË HUMBIN, MUNDEN VETËM TË FITOJNË



të majtë Mevlan Murati, thotë se atë dhe shokët e skuadrës i pret një përballje e vështirë, por pranon se janë maksimalisht të përgatitur dhe se besojnë në kualitetet e tyre. "Me Sallzburgun na presin dy ndeshje të vështira. Duhet të jemi maksimalisht të përgatitur për këto ndeshje. Si ekip kemi analizuar kundërshtarit dhe jemi përgatitur mjaftë mirë. Besojmë në kualitetet tona sepse nuk jemi rastësisht këtu dhe do japim më të mirën nga vetja që të kalojmë në 'play off' të Çampionist. Atmosfera është në nivelin e duhur, jemi të vetëdijshëm për ndeshjen dhe rëndësinë e saj dhe vet fakti që jemi këtu motivimi është në maksimum dhe jemi të përgatitur mirë për tu përballur me Sallzburgun", deklaroi për gazetën

KOHA, Murati. Ndryshe, kuqezinjtë do të jenë edhe më të fortë për këtë përballje, pasi në kombinim për këtë sfidë do të jetë përforsimi i fundit Gledi Mici, i cili mori lejen e duhur nga UEFA për të luajtur. Në anën tjetër futbollisti nga Mali në radhët e Sallzburgut, Diadi Samaseku thotë se e respektojnë Shkëndijen dhe në asnjë mënyrë nuk duhet ti nënçmojnë ata. "Nëse dikush flet për 'play-off'-in, atëherë gabon. Shkëndija ka shumë kualitet, sidomos në pjesën e sulmit. Duhet patjetër të jemi maksimalisht të koncentruar nëse dëshirojmë të plasohemi në fazën tjetër të Ligës së kampionëve", deklaroi Samaseku. Ndërkohë, përballja mes Sallzburgut dhe Shkëndijës fillon në ora 19.00.

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 7 gusht - Skuadra e Shkëndijës sot (e mërkurë) do të zhvillojë përballjen e parë me Sallzburgun në kuadër të raundit të tretë të Ligës së kampionëve. Kuqezinjtë janë në gjysmë të rrugës për të arritur deri te caku i dëshiruar, plasmani në plej-of edhe pse rivali i tyre është një skuadër e madhe, kampionia e Austrisë, dhe e cila se-

zonin e kaluar në "Europa League" arriti deri në gjysmëfinale. Pas TNS-së dhe Sheriff Tiraspolit, për djemtë e trajnerit Qatip Osmani kjo përballje është një sfidë e madhe, por ata nuk ndejnë presion pasi nuk kanë se çfarë të hum-

bin, por munden vetëm të fitojnë. E themi këtë pasi edhe në rast të eliminimit nga Liga e kampionëve, Shkëndija do të luajë në 'play-off' të Liga Evropës, për herë të dytë pasi më herët ata u eliminuan nga skuadra belge Gent. Mbrojtësi i krahu

BEHRAMI FAJËSON FEDERATËN E ZVICRËS PËR LARGIMIN E TIJ

Për të sqaruar largimin e tij, ai e ka bërë një intervistë me gazetën zvicerane, "blick.ch", ku tha se Federata e Futbollit të Zvicrës nuk e trajtoi atë siç duhet, pasi që lajmin se ai nuk është më pjesë e projektit ia thanë vetëm përmes telefonit



Pas lajmit se mesfushori i Zvicrës me origjinë shqiptare, Valon Behrami, është larguar nga Kombëtarja e Zvicrës, nuk ishte e qartë se pse ai e mori këtë vendim. Për të sqaruar largimin e tij, ai e ka bërë një intervistë me gazetën zvicerane, "blick.ch", ku tha se Federata e Futbollit të Zvicrës nuk e trajtoi atë siç duhet, pasi që lajmin se ai nuk është më pjesë e projektit ia thanë vetëm përmes telefonit. Ai gjithashtu flet për festimin me shqiponjë të Xhakës dhe Shaqirit dhe e tregon efektin që e kishte ajo te skuadra.

- Valon Behrami, juve iu ka telefonuar Vladimir Petkovici të hënën pasdite. Çfarë të tha?

Behrami: Dua të them, ishte një telefonatë njerëzore. Por në atë telefonatë, ai dëshironte të më tregonte derën e Kombëtares. Një muaj pas humbjes në Kupën e Botës në Rusi, kishte dinamika të cilat nuk më pëlqenin.

- Çfarë dinamika?

Behrami: Dinamika të cilat nuk i përshtateshin qëllimit tim në skuadër. Unë gjithmonë e kam promovuar unitetin. Skuadra duhet të jetë gjithmonë e bashkuar, si në situata pozitive, ashtu edhe në situata negative. Te ne, kishte një ndarje. Por si djalë i ri, unë tentova të ndërtoj një skuadër, kështu jam rritur

PETKOVIÇ: VENDIMI NUK ËSHTË AS PËRFUNDIMTAR E AS POLITIK

Valon Behrami në një intervistë për Radiotelevizionin e Zvicrës ka thënë se e ka pranuar një telefonatë nga trajneri Petkoviç, e cila kishte zgjatur vetëm 30 sekonda. Petkoviç i kishte thënë atij se shqiptari nuk bën më pjesë në planet e tij. Behrami kishte thënë se largimi i tij nga

unë. Sporti, dhe mbi të gjitha futbollit, i bashkojnë kombësitë dhe kulturat e reja. Rezultati është një kombëtare e bashkuar dhe kjo është ajo që e karakterizonte Zvicrën. Gjithmonë kam luftuar për këtë gjë.

- Çfarë do të thuash me ndarje? A është fjalë për festimin me shqiponjë të Xhakës dhe Shaqirit dhe reagimet që ka shkaktuar kjo?

Behrami: Pajtohem. Ai gjest na ndau neve, tregoi një anë tjetër tonën. Ne jemi duke shkuar në një drejtim dhe duam të krijojmë një ambient të mirë rreth nesh, gjë që e bën krenar Zvicrën. Pastaj u larguam nga Kupa e Botës. Në këtë pikë, është e lehtë të kritikosh, të gesh një ndarje mes nesh. Neve na thanë se e preferojmë një kombë të shumë se tjetrit, por ne e kemi dëshmuar se ne i përkasim vetëm një kombësie. Ne gjithmonë e kemi përgjegjësinë si zviceran, si në fitore ashtu edhe në humbje.

- Ata gjithmonë tentonin të krijojnë unitet brenda skuadrës.

Kombëtarja ishte vendim politik, mirëpo trajneri aktual i 'Helvetikëve' e ka mohuar këtë. "Ky është vendim im, dhe është i bazuar në kriteret sportive. Nuk ka të bëjë aspak me politikë. Unë kam menduar për këtë, i kam kontaktuar disa lojtarë, por ende nuk e kam marrë vendimin final", ka thënë Petkoviç.

Tani ndjeheni sikur të kanë vendosur para derës.

Behrami: Gjithmonë kisha menduar se do të largohesha më herët. Por, këtë vit ndjehesha sikur isha integruar plotësisht brenda skuadrës dhe ndjehesha si lider. Dhe tani më kanë lënë para derës. Trajneri mund të thotë çfarë të dojë. Është një vendim politik. Unë gjithmonë e kam mbrojtur veten kundër njerëzve që nuk e kuptojnë se çfarë është futbollit. Ju nuk keni luajtur asnjëherë futboll! Ky është problem i madh me shoqatat e Zvicrës. Ata gjithmonë tentojnë të ruajnë pozitën e tyre, por nuk e kanë asnjë ide se si ndjehen lojtarët. Njerëzit thonë se ne kurrë nuk u munduam. Kjo më lëndon. Por e di, kështu është. Në të njëjtën kohë, e gjitha kjo nuk është problem shumë i madh për mua. Tani kam më shumë kohë për vajzat dhe gruan time. Isha i pasigurt gjatë vendimmarrjes, kështu që nuk është në pyetje egoizmi. Unë jam

33-vjeçar, me siguri do të pensionohesha kur të jem 35-vjeçar. Nuk ka asnjë problem. Gjithmonë kam provuar të jap më të mirën time, ju e keni parë këtë gjë. Në fillim ishte e vështirë, por pastaj reagoval fuqishëm. Dua ta përsëris edhe një herë: unë gjithmonë kam marrë përgjegjësi. Edhe sot, po ashtu. Qëndroj faqebardhë dhe them se është gabim të më tregoni në këtë mënyrë se nuk jam më pjesë e projektit tuaj. Dua të ma thonë këtë vendim ballë përballë. Kjo gjë nuk ndodhi. Të gjithë e panë se çfarë ndodhi pas ndeshjes kundër Suedisë. Dhe tani duket se kjo ka çuar deri te ky vendim. Por unë kam thënë: Qëndroj këtu, nuk dua t'iu ndodhin gjëra të këqija. Unë mund të largohem, udhëtimi im është afër përfundimit. Njerëzit të cilët u prekën nga kjo gjë, më telefonuan për të kërkuar ndihmë. Unë i dola në ndihmë.

- Cilët njerëz? A mund ta thoni një emër?

Behrami: Sekretari i përgjithshëm. Atëherë Miescher. Ai i ka kritikuar lojtarët e kombëtares me dy kombësi. Edhe pse, ju nuk i keni dy pasaporta. Për shembull, a nuk donin më Xhaka dhe Shaqiri të luanin për Kombëtaren e Zvicrës? Jo saktësisht ata të dy, por ka lojtarë që reagon në mënyrë të dhunshme. Unë gjithmonë kam tentuar t'i qetësojë. Pastaj sekretari i përgjithshëm më telefonoi dhe më kërkoi ndihmë për t'i qetësuar kolegët. Unë e bëra këtë gjë pasi gjithmonë kam dashur të kem një skuadër të bashkuar, e jo të ndarë. Ai thotë se më ka shkruar një mesazh specifik. Kjo gjë nuk ka ndodhur kurrë. Gjithçka ndryshoi dhe tani ndodhemi në këtë situatë.

- A ndjeheni më shumë i zhgënjyer apo i zemëruar?

Behrami: Unë jam i zhgënjyer. Gjithashtu, jam njeri, kam ndjenja për njerëzit këtu. Po flas për trajnerin dhe të gjithë grupin. Si person, kjo po më lëndon shumë. E di se zhgënjime të tilla janë pjesë e karrierës së një futbollisti, e di se këto ndodhin shpejt. Por, unë mendoja se mund t'i besoja disa njerëzve të caktuar sa i përket fatit tim, të paktën. Të ma thonë atë në fytyrë. Ta vendosin dorën e tyre mbi shpatullat e mia. Dhe jo të ma thonë në një telefonatë 30 sekondëshe se unë më nuk jam pjesë e projektit të tyre.

Në bazë të nenit 157, 158, 159, 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Lajmërimet nga Ministria e financave nr. 18-6694/2 të datës 16.06.2018 dhe Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 0202-958 të datës 06.08.2018 nga u. D. Drejtori i IPSH Enti për rehabilitim të dëgimit, të folurit dhe zërit, publikohet

SHPLLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar,

1. IPSH Enti për rehabilitim të dëgimit, të folurit dhe zërit ka nevojë për punësim të:

1.1 3 (tre) Defektologë të diplomuar – bashkëpunëtor profesional për punë në territorin e Qytetit të Shkupit;

1.2 4 (katër) Logopedë të diplomuar - për punë në territorin e Qytetit të Shkupit;

1.3 1 (një) Logoped të diplomuar – për punë në territorin e Komunës së Negotinës

2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore

- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

3. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim:

Për kandidatin nga pika 1.1

- Arsim sipëror të mbaruar Defektolog i diplomuar (minimum 240 SETK / shkalla VII/1),
- Vërtetim për njohje të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane).
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Me ose pa përvojë pune.

Për kandidatin nga pika 1.2

- Arsim sipëror të mbaruar Logoped i diplomuar (minimum 180 SETK / shkalla VI-A)
- Provim të dhënë profesional,
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Vërtetim për njohje të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane).
- Me ose pa përvojë pune.

Për kandidatin nga pika 1.3

- Arsim sipëror të mbaruar Logoped i diplomuar (minimum 180 SETK / shkalla VI-A)
- Provim të dhënë profesional,
- Njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Vërtetim për njohje të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane)
- Me ose pa përvojë pune.

4. Orari i punës prej 40 orëve në javë dhe neto pagesa fillestare:

- Për kandidatët nga pika 1.1 është 24.200,00 denarë.
- Për kandidatët nga pika 1.2 është 22.300,00 denarë.
- Për kandidatët nga pika 1.3 është 22.300,00 denarë.

5. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët obligohen që të parashtojnë dokumentet në vijim

Për kandidatin nga pika 1.1

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt (adresa, telefoni celular, e-mail)
- biografia e shkurtë (CV)
- Dëshmi për arsimin sipëror të mbaruar – Diplomë ose certifikatë Defektolog i diplomuar me minimum 240 SETK ose shkallë VII 1 me sukses të theksuar mesatar (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- Vërtetim për njohje të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane).
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter).

Për kandidatët nën pikën 1.2 dhe 1.3

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt (adresa, telefoni celular, e-mail)
- biografia e shkurtë (CV)
- Dëshmi për arsimin sipëror të mbaruar – Diplomë ose certifikatë Logoped i diplomuar me minimum 180 SETK ose shkallë VI A me sukses të theksuar mesatar (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- dëshmi për provim të dhënë profesional (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë
- Vërtetim për njohje të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane).
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter),
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (original ose kopje të vërtetuar në noter).

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike me dokumentacion të kompletuar është deri më 14.08.2018.

7. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

8. Komunikimi me kandidatët do të realizohet përmjet mjeteve elektronike (SMS, telefonin celular dhe e-mailit).

9. Fletëparaqitja me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të parashtohen deri në IPSH Enti për rehabilitim të dëgimit, të folurit dhe zërit – Shkup rr. Bellgradska nr. 15 – Shkup, përmes postës ose në arkivin e IPSH Enti për rehabilitim të dëgimit, të folurit dhe zërit – Shkup, ndërsa me shenjë për Shpallje publike për punësim dhe domosdo me shenjë për cilën pikë (vend pune) parashtohet fletëparaqitja.

Telefoni për kontakt: 02/3239-226

IPSH Enti për rehabilitim të dëgimit, të folurit dhe zërit – Shkup
U. D. Drejtor
D-r sci. Silvana Filipova, logoped

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM 167/20 15), nenit 77, 79, 80 dhe 82 nga Ligji për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14 dhe 135/14) Drejtori i SHFK „Kirili dhe Metodij“, fsh. Rramanli Kumanovë shpall

Konkurs
Për punësim të një punëtori me kohë të pacaktuar

1. Një pastrues për në ShFP „Agino Selo“, me pagë mujore 12,176 den .

Kandidatet mund të konkurrojnë në shpallje të konkursit çdo ditë prej ora 07 deri më 16 ora me dokumentet e kompletuara dhe që kanë të mbaruar arsimin përkatës në bazë të ligjit për arsimin fillor.

Konkursi do të jetë i shpallur 5 ditë pune prej ditës së shpalljes ne SHFK „Kirili dhe Metodij“, Fsh. Rramanli, e-mail adresa kiril.metodij@mail.net.mk

Drejtori
Selver Shabani

I nr. 713/2018

SHPLLJE PUBLIKE
(Në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përbarim, Gazeta zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përmbareusi Vanço Markovski duke vepruar sipas propozimit të kreditorit UNI BANKA SHA SHKUP nga Shkupi dhe me seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, kundër borxhliut Nazif Iljazi nga Tetova me banim në rr. Jordan Zlatanovski nr. 50, për shkak të realizimit në të holla, më datë 31.07.2018.

FTON

Borxhliun Nazif Iljazi i lindur më datë 17.10.1993 të paraqitet në zyrën e përmbareusit në rr. Hlindenska nr. 64 Tetovë, për shkak të dorëzimit të akteve në vijim:

- Urdhëresës për përbarim I nr. 713/2018 të datës 18.06.2018, të përpiluar në bazë të nenit 226 paragrafi 2 të LP;
- Urdhëresës për përbarim I nr. 713/2018 të datës 18.06.2018 të përpiluar në bazë të nenit 166 të LP;
- Konkluzionit për mënyrën e dorëzimit nga data 31.07.2018.

NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE, duke konsideruar nga dita e publikimit të fundit të kësaj ftese publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHET borxhliu Nazif Iljazi se mënyra e kësaj dhe dorëzimit konsiderohet si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vet pala.

Kjo shpallje paraqet SHPLLJEN E PARË të thirrjes publike.

PËRMBARUES
Vanço Markovski

I nr. 797/2017

SHPLLJE PUBLIKE
(Në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përbarim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përmbareusi Vanço Markovski duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Univerzalna Investiciona Banka SHA Shkup nga Shkupi dhe seli në rr. Maksim Gorki nr. 6, kundër borxhliut Adem Ibishi nga Tetova me seli në rr. B. Toska nr. 98, për shkak të realizimit të kërimit të të hollave, më datë 31.07.2018

FTON

Borxhliun Adem Ibishi të lindur më datë 02.09.1966 të paraqitet në zyrën e përmbareusit në rr. Hlindenska nr. 64 Tetovë, për shkak të dorëzimit të urdhëresës për përbarim I nr. 797/2017 të datës 16.07.2018, të përpiluar në bazë të nenit 166 të LP, dhe konkluzionit për mënyrën e dorëzimit të aktit I nr. 797/2017 të datës 31.07.2018, NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE, duke konsideruar nga dita e publikimit të fundit të kësaj ftese në gazetën ditorë.

PARALAJMËROHET borxhliu Adem Ibishi se mënyra e kësaj dhe dorëzimit konsiderohet si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vet pala.

Kjo shpallje paraqet SHPLLJEN E PARË të thirrjes publike.

PËRMBARUES
Vanço Markovski

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në “Momin Potok” – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

Në bazë të nenit 116 paragrafi 1 alineja 5 e Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18), nenit 33 paragrafi 1 alineja 6 të Statutit të Institucionit publik komunal për fëmijë – Çerdhes për fëmijë “Goce Dellçev” – Viniçë, ndërsa në pajtim me Vendimin nr. 10-736 të datës 25.07.2018 për publikim të shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit të Institucionit publik komunal për fëmijë – Çerdhes për fëmijë “Goce Dellçev” – Viniçë, të sjellë nga kryetari i komunës së Viniçës, Këshilli drejtues i IPKÇF “Goce Dellçev” Viniçë, publikon

SHPLLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të drejtorit të IPKÇF “Goce Dellçev” Viniçë

Për drejtor të çerdhes publike për fëmijë mund të zgjidhet personi i cili krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj edhe kushtet e caktuara në nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve është me arsim sipëror (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar) dhe plotëson kushtet të caktuara në nenin 136 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve për edukator, bashkëpunëtor profesional, person me fakultet të mbaruar filologjik – programi studimor mësimor dhe studime të specializuara për pedagogë parashkollor, jurist, sociolog dhe ekonomist me arsim sipëror të mbaruar (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar) dhe minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit, posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English:Legal) – së paku niveli A2, FCE (Cambridge English:First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë, gjegjësisht APTIS – së paku niveli B2 dhe posedon licencë valide për drejtor të institucionit për fëmijë.

Së bashku me Fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:

- diplomë për arsimin sipëror të mbaruar;
- certifikatë të shtetësisë;
- certifikatë të mjekut;
- Deklaratë të plotësuar dhe të nënshkruar me dorë se kandidati njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- vërtetim për përvojë pune;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese;
- certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- licencë për drejtor të institucionit për fëmijë.

Kandidati për drejtor të institucionit publik për fëmijë obligohet të parashtojë edhe program për punë të çerdhes për fëmijë. Kushtet për posedim të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht ose certifikatës për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet aplikohen prej më 1 shtator 2018.

Kandidati i cili zgjidhet për drejtor obligohet që kushtin për njohje të gjuhës angleze ta përmbushë më së voni në afat prej një viti duke konsideruar nga dita e zgjedhjes.

Drejtori zgjidhet gjegjësisht emërohet për periudhë prej 4 vjet.

Shpallja zgjatet tetë ditë nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet nga ana e kryetarit të komunës në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së propozimit nga ana e Këshillit drejtues.

Dokumentet e nevojshme të parashtohen deri tek Këshilli drejtues i IPKÇF “Goce Dellçev” Viniçë, rr. “Stiv Naumov” pn, Viniçë me shënim “për shpallje publike për zgjedhje të drejtorit”.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruaras pas afatit nuk do të merren parasysh.

Këshilli Drejtues
Zëvendëskryetar
V. Ilievska

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor

MKD
СЕРТИФИКАТ
MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë

SHPLL
Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzim të ujit për kultivimin e peshqve prej lumit Beleshnica PK 1030 KK belica, Komuna Makedonski Brod.

Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit të ujërave (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14 dhe 146/15), deri të Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë është dorëzuar kërkesë për dhënie e Lejes për përdorimin e ujit për rritjen e peshqve prej Belashnica PK 1030 KK Belica, Komuna e Makedonski Brod me PAI nr. 11-895 prej 12.06.2018

Parashtues i kërkesës
SHKPJNP “TABANA”
Rr. “Metodija Shatorov Sharlo” nr. 8/17
1000 Shkup

Koordinatat e lokacioneve ku merret uji sipas sistemit nacional të koordinatave:

Pikat prej ku merret uji	
X=4 615 106,939	Y=7 523 820,491
X=4 615 094,917	Y=7 523 833,188
X=4 615 081,135	Y=7 523 818,440
X=4 615 090,519	Y=7 523 805,938
Pikat prej ku lëshohet uji	
X=4 615 298,928	Y=7 523 186,265

Informata në lidhje me kërkesën, opinionin i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail j.nikolov-delovska@mocpp.gov.mk

Opinionin i përfshirë, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të dorëzojë mendime dhe komente në formë të shkrim deri në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bulevardi Goce Dellçev nr. 18 ndërtesa e RIM (kati 10), 1000 Shkup.

I nr. 088/2018

SHPLLJE PUBLIKE
(Në bazë të nenit 179 paragrafi 5 të LP të Publikuar në Gazetën Zyrtare të RM nr. 72 të datës 12.04.2016)

Përmbareusi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Shoqëria për shërbime intelektuale dhe tregti, të bazuar në dokumentin përbarim NPN nr. 312/2017 të Notarit Bashkim Elezi nga Gostivari, Kundër Shoqërisë për punësim të personave invalidor ndërtimtarit tregti dhe shërbime XHIMI KO SHPKNJUP eksport-import Gostivar, për lëndën përbaruese të nën I nr. 088/2018 me datë 06.08.2018

FTON

- Zafrovski Qiro Зафировски Кирило me adresë në Kozle 174, Shkup,
- Ilkovski Mario rr. Dramska nr. 8, Shkup,
- Irena Gjorgjievska me adresë Hristo Tatarçev 7/5, Shkup,
- Kosta Tupuzoski me adresë Todor Aleksandrov 83/1/4, Shkup,
- Kostadina Galimaska Popovska me adresë Kole Nedelkovski 15 A, Shkup-Çair,
- Mirjana Topuzoska me adresë Todor Aleksandrov 83/1/4, Shkup,
- Savaški Sasho me adresë Predrag Jančevski 36, Tetovë,
- Sevinç Ali Osman R. Gjermanisë,
- Tomiq Tomislav bul. Partizanski Odredi 153/1/60, Shkup,
- SHOQËRIA TREGTARE PËR NDËRTIMTARI, TREGTI DHE SHËRBIME EUROPROFIL SHPKNJUP EKSPORT-IMPORT me adresë Nikolla Vapcarov 2/1/1, Shkup
- Tugjarova Gjorgjova Smila bul. Jane Sandanski 35/1/10, Shkup, të vijnë në zyrën e Përmbareusit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në rr. “Zhviko Brajkovski nr. 23” për shkak të dorëzimit të:

Konkluzionit për shite publike me gojë nga data 30.07.2018 I nr. 088/2018 të Përmbareusit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari, në afat prej 2 (dy) ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit në gazetën ditorë Nova Makedonija dhe Koha, për shkak të realizimit të së drejtës ligjore për blerje të drejtëpërdrejtë.

PËRMBARUES
Aleksandar Kuzmanovski

Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. “7 korriku” nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 071 372 221



Juventus ka gati kontratën e re për Pjanićin

Pavarësisht thashethemeve të merkatos dhe qasjes ndaj Real Madridit, Miralem Pjanić nuk duket i destinuar të largohet nga Juventus këtë verë. Boshnjaku është kthyer nga turneu i SHBA dhe ka takuar agjentët e tij për të folur kryesisht për një temë: rinovimi me Juventusin. Sipas "La Gazzetta dello Sport", boshnjaku është ende në qendër të projektit të Alegri dhe Marotta është gati ta njohë atë siç duhet. Me Fali Ramadanin, agjentin e ri të Pjanić, drejtuesit bardhezinj do të përpiqen të gjejnë një marrëveshje me bazë 6 milionë euro në sezon, me zgjatje të mundshme të kontratës deri në vitin 2023 (kontrata aktuale skadon në vitin 2021). Pra, po shkojmë drejt një qëndrimi të Pjanić te Juventus, të paktën edhe për këtë sezon. Në fakt, është e vështirë të fitosh 100 milionë euro (shifra e kërkuar nga Juventus) nga Real Madridi, ose Premier Liga, duke pasur parasysh se në Angli merkatoja mbyllet për dy ditë. Por, në tregun e transferimeve, ju e dini, gjithçka është e mundur dhe prandaj Juventus mbetet i gatshëm të dëgjojë çdo marrëveshje super. Në fund të fundit, zëvendësuesi tashmë është nën mbikëqyrje prej një kohe të caktuar dhe quhet Milinković-Savić. Shitja e mundshme e Pjanićit do të shkaktojë zyrtarisht sulmin ndaj serbit të Lacios, por për momentin ne jemi vetëm në fushën e hipotezave.

TELENOVELA "MODRIÇ"

REALI DENONCON INTERIN NË UEFA!

Sipas "El Mundo Deportivo", skuadra "merengues" ka kërkuar ndihmën e UEFA-s për të ndaluar largimin e kroatit. Arsyeja është se paratë të cilat Interi do të përdorë për blerjen e Modrić janë të paligjshme

Te Real Madridi nuk e kanë marrë aspak mirë lajmin se Luka Modrić kërkon të largohet, pas ofertës që skuadra e Interit i ka bërë mesfushorit kroat. Sipas "El Mundo Deportivo", skuadra "merengues" ka kërkuar ndihmën e UEFA-s për të ndaluar largimin e kroatit. Arsyeja është se paratë të cilat Interi do të përdorë për blerjen e Modrić janë të paligjshme. "Modrić është i tentuar nga oferta e Interit dhe agjentët e tij kërkojnë që lojtari të transferohet në Itali sezonin tjetër, ashtu sikurse Jorge Mendes bëri me Cristiano Ronaldo. Oferta e Interit është 15 milionë të paguara që tani për huazimin dhe 20 milionë pas një



viti. Një shumë e ulët për mesfushorin më të mirë në botë", shkruan e përditshmja spanjolle, duke cituar burime nga klubi madrilene.

"Por Reali po kërcënon Interin që të lërë në mes bisedimet, duke iu drejtuar UEFA-s për shkak të 'Fair Play Financiar'. Sipas skuadrës "merengues", zikaltërit do të paguajnë një pjesë të kësaj shumë nga paratë që vijnë direkt nga

sponsorizimet e Suning. Ashtu sikurse Paris Sen Zhermeni bëri një vit më parë me Nejmarin. Interi i ofron një kontratë 4-vjeçare lojtarit, me vlerën e 10 milionë euro në sezon dhe i garanton tërheqjen nga sporti në Kinë, me një kontratë maramendëse", thotë "El Mundo". Në anën tjetër trajneri i Realit, Julen Lopetegui është i bindur se Luka Modrić do të jetë shumë i lumtur duke luajtur për

Real Madridin në sezonin e ri. "Unë u përgjigja edhe dje, – u tha Lopetegui gazetarëve, kur e pyetën për të ardhmen e Modrić. – Presidenti foli me zë të lartë dhe nuk kemi dyshim më të vogël se Modrić do të vazhdojë të jetë i lumtur, duke luajtur me ne. Nuk ka asgjë të re. Nëse kam folur me Modrić? Natyrisht, flas me lojtarët e mi, por bisedat mbeten private", deklaroi Lopetegui.

Junajted refuzon ofertën e parë për Pogban

Pol Pogba është kthyer në një çështje të nxehtë në shtëpinë e Mançester Junajted. Menaxheri i tij, Mino Raiola, kërkon me ngulm që klubi anglez të lejojë transferimit e tij të Barcelona, por "Djajtë e Kuq" po rezistojnë. Mësohet se të hënën në mbrëmje Junajted ka refuzuar ofertën e parë të "blaugranave", 44 milionë sterlina, plus kartonin e Jerry Minas dhe Andre Gomesit. Më Mançesterin, kur kanë mbetur vetëm dy ditë nga mbyllja e merkatos në hyrje, Pogbanë e konsiderojnë të pashitshëm. Mino Raiola, në fakt, por bën presion të madh që klienti i tij të largohet nga "Old Trafford", por qëndrimet e tij të fundit po i



interpretojnë si tentativa për t'i rritur pagën futbollistit deri në 500 000 sterlina në javë, duke barazuar atë të Alexis Sanchez, që për momentin është në majë të hierarkisë së pagave. Barcelona ka kohë deri në fund të muajit për të bindur Mançester Junajte-

din, por problemi qëndron në faktin se "Djajtë e Kuq" tashmë e kanë të pamundur të gjejnë një zëvendësues në merkato, pasi pas datës në gusht nuk mund të kryejnë asnjë blerje. Gjithsesi, nuk përjashtohen zhvillime të reja në ditët në vazhdim.



Hart arrin marrëveshje me Barnlin

Xho Hart është portieri i ri i skuadrës së Barnli, ekipi surprizë i sezonit të kaluar, që do të luajë edhe në 'Europa League' sezonin e ri 2018-2019. Lajmin e kanë konfirmuar të dyja klubet përmes mesazheve në rrjetet sociale, që zyrtarizojnë këtë transferim të portierit 31-vjeçar. Ndryshe, Hart largohet kështu nga Mançester Siti pas 12 sezonesh edhe pse në dy të fundit ka luajtur në formë huazimi, fillimisht te Torino e më pas tek Uest Hemi. Barnli ka paguar 4 milionë euro për të marrë ish-portierin e kombëtares angleze (kontratë 2-vjeçare me të drejtë rinovimi edhe një vit), por që vitet e fundit ka humbur fanellën e "3 luanëve", madje nuk u thirr në kombëtare në Botërorin "Rusi 2018". Te skuadra e Barnli janë edhe portierët Nik Pope e Tom Heaton, por të dy janë të dëmtuar, ndaj Hart pritet të jetë titullar në javën e parë të Premier Ligës.

Jam i lumtur te Lioni, por gjithçka është e mundur

Kapiteni i Olimpik Lion, Nabil Fekir, e ka lënë derën hapur për një largim gjatë këtij muaji. Sulmuesi anësor mbetet një ndër objektivat e Liverpoolit, ndërsa Çelisi po bën lëvizje para mbylljes së afatit kalimtar të Ligës Premier. I pyetur për gjendjen e tij, mesfushori ka thënë se çdo gjë është e hapur deri në momentin e fundit. "Nëse mendoj të qëndroj në OL? Siç mund ta shikoni, unë jam në Lion, jam shumë mirë këtu, por dritarja e transferimit është ende e gjatë dhe gjithçka lëviz shumë



shpejt në futboll", shprehet Fekir. "Ne nuk e dimë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen, por jam shumë mirë në Olympique.

Ndihem mirë në grup, kemi lojtarë shumë të mirë, kemi një atmosferë të mirë. Një përzierje mes të rinjve dhe të moshuarve, me lojtarë më me përvojë se të tjerët", shtoi më tej ai. "Ekziston një grup i mirë, shumë homogjen. Ne jetojmë mirë dhe shpresoj që OL të ketë një sezon shumë të mirë", përfundoi lojtari që ka fituar muaj më parë Kupën e Botës me Francën. Ndryshe, 25-vjeçari deri më tani ka pasur 115 paraqitje për Lionin në të gjitha garat dhe ka shënuar 45 gola.



Kroenke gati të kompletojë blerjen e Arsenalit

Stan Kroenke do të përfundojë një blerje të pabesueshme të Arsenalit, që do të shohë vlerën e përgjithshme të klubit në 2.3 miliardë dollarë. Kroenke është aksionari më i madh në stadiumin "Emirates", por tani ka bërë një ofertë për të blerë 30 për qind të aksioneve të klubit të Alisher Usmanov, duke i dhënë kështu kontroll të plotë. Dhe "goal.com" kupton se Usmanovi ka pranuar kushtet e ofertës dhe tani do të marrë 712 milionë dollarë për aksionet e tij. Në një deklaratë të lëshuar nga Kroenke lexohet: "Ne në KSE po ecim përpara me këtë ofertë, që çon në 100 për qind të pronësisë së klubit. E vlerësojmë përkushtimin e z.Usmanov në Klubin e Futbollit të Arsenalit dhe historinë që përfaqëson klubi", thonw nga kompania e Kroenkes. "KSE UK ka kënaqësinë të shpallë termat e ofertës së saj në të holla për të blerë të gjithë emetimin dhe për të emetuar kapitalin e zakonshëm aksionar të 'Arsenal Holdings PLC', përveç aksioneve të Arsenalit, që tashmë janë mbajtur nga KSE", shtoi mw tej kompania e Kroenkes "KSE". "KSE", një korporatë tërësisht në pronësi të E.Stanley Kroenke, aktualisht zotëron 41,743 aksione tek Arsenali, që përfaqëson rreth 67.09 për qind të kapitalit ekzistues të emetuar të Arsenalit". Kroenke mori pjesë për herë të parë tek Arsenali në vitin 2007 dhe ka rritur gradualisht aksionet e tij në klub, të cilat aktualisht janë në kuotën 67 për qind.

10 LOJTARËT QË DUHET TA VENDOSIN TË ARDHMEN E TYRE NË MË PAK SE TRE DITË



Pogba dëshiron të largohet nga Mançesteri, pasi ka një marrëdhënie tepër të ftohtë me Murinjon. Sidoqoftë, çmimi i këtij kampioni bote dhe paga e tij e bëjnë të vështirë këtë gjë. Edhe pse gjithçka është e mundur me një menaxher si Raiola. Barça ka bërë ofertën e saj, por francezi duket se dëshiron të rikthehet te Juventus, për të luajtur përkrah Kristiano Ronaldos

Edhe pak kohë na ndajnë nga fillimi i sezonit të ri futbolistik në Premier League. Të enjten, më 9 gusht, në orën 18:00, sipas orës sonë lokale, merkatoja që lëviz më shumë para në futbollin botëror, ajo e Anglisë, mbyllet. Dhe ka jo pak nga ata lojtarë mjaft të njohur, që duhet të zgjidhin të ardhmen e tyre brenda tri ditëve. 10 prej tyre, më të habitshmit, janë si në vijim, më poshtë:

ENTONI MARTIAL

I kritikuar nga Hoze Murinj për arsye sportive dhe jashtë sportit, sulmuesi duket se ka arritur kulmin e tij të durimit. Për pasojë, është i etur të gjejë një dalje nga rruga e njëjtë me "Djajtë e Kuq", ku aktivizimi me trajnerin portugez duket me pikatore, ose fare i pamundur.

LUKAS PEREZ

Nuk ka vend në formacionin e trajnerit Unai Emery. Sporting nga Portugalia dhe Uest Hemi "luftojnë" për t'i marrë shërbimet e tij.

EDEN HAZARD

Ai ka bërë gjithçka të mundshme për të shkuar te Real Madridi, por klubi i bardhë

nuk është i gatshëm të paguajë milionat e shumta, të kërkuara nga Çellsit. Duket sikur belgu do të vazhdojë në Londër.

HARI MAGUIRE

Një nga zbulimet angleze në Kupën e Botës së Rusisë, ai lakmohet nga Mançester Junajtedi, me Jose Murinjon të dëshpëruar për qendërmbrojtësin. Leicester Siti, klubi i tij, luan me ankthin e gjeneruar nga trajneri portugez.

ARON RAMSEJ

Atij i përfundon kontrata në vitin 2019 me Arsenalin. Çellsit dhe Uest Hemi janë dy nga skuadrat, me të cilat është i lidhur nga zërat e merkatos së kësaj vere.

XHORDAN PIKFORD

Ai është në listë për të marrë përsipër mbrojtjen e portës në "Stamford Bridge", por nuk është i vetmi kandidat. Evertoni, pas paraqitjes së bërë me Anglinë në Kupën e Botës së Rusisë, mund të jetë klub shumë i vogël për të.

TOBI ALDERVEIRELD

Nuk ishte i padiskutueshëm për trajnerin Pokettino sezonin e kaluar. Është konfirmuar në Kupën e Botës së Rusi-

së dhe shihet si alternativë për të forcuar disa mbrojtje. Thuhet se Mançester Junajtedi ka një marrëveshje me të, por duhet që Totenhemi të sigurojë zëvendësuesin e belgut, që ai të transferohet në "Old Trafford".

TIBAUT KURTOA

Atij i përfundon kontrata për një vit dhe dëshiron të luajë në Madrid, për arsye personale. Real Madridi është duke pritur për të dhe Çellsit është në kërkim të zëvendësuesit.

VILFRIED ZAHA

Çellsit dhe Totenhemi po luftojnë për këtë ish-lojtar të Mançester Junajtedit, që duket në rrugën e lënies së Kristall Pallas.

POL POGBA

Ai dëshiron të largohet nga Mançester Junajtedi, pasi ka një marrëdhënie tepër të ftohtë me Hoze Murinjon. Sidoqoftë, çmimi i këtij kampioni bote dhe paga e tij e bëjnë të vështirë këtë gjë. Edhe pse gjithçka është e mundur me një menaxher si Raiola. Barça ka bërë ofertën e saj, por francezi duket se dëshiron të rikthehet te Juventus, për të luajtur përkrah Kristiano Ronaldos.

RIVALËT SHPENZOJNË MILIONA NË MERKATO

Totenhemi vazhdon "gjumin"

Premier Liga është kampionati me klubit më të pasura në botë. Ekipeve "BIG" kanë shpenzuar si çdo vit shuma marramendëse, ndërsa nuk kanë ngelur prapa dhe skuadrat më të vogla, që kanë shpenzuar të paktën nga 30 miliona euro secila. Por, ka një përjashtim... Bëhet fjalë për klubin e Totenhemit. Skuadra e cila u rendit e treta në sezoni e kaluar, nuk ka kryer qoftë edhe një blerje, kur kanë mbetur vetëm tri ditë nga mbyllja e merkatos në kampionatin anglez. Gjendja

është alarmante, por tekniku argjentinas i "gjelave" Mauricio Pokettino nuk dihet fort i shqetësuar nga ky fakt. "Kam një skuadër fantastike. Tani siguroam dhe pesë rinovime kontratash çka më bëjnë shumë optimist për të ardhmen e ecurinë e këtij klubi në të ardhmen. Çdo trajner dëshiron që të ketë një kontingjent sa më cilësor, prandaj pres afrime, por mund të bëjmë dhe pa to", tha Pokettino, duke treguar një sjellje krejt të kundërt nga homologu i tij Hoze Murinj, i



cili prej më shumë se dy javësh po ushtron presion ndaj drejtuesve të Mançester Junajtedit, duke theksuar se ekipi i tij ka shumë mangësi dhe nuk është i denjë për garuar për titullin e Premier Ligës.

SportFlash

Çellsit në sulm për Oblak

Me Thibaut Kurtoa, i cili u ka komunikuar drejtuesve të klubit dhe teknikut Sarri se dëshiron kalimin te Real Madridi, Çellsit nuk rri duarkryq, por ka nisur menjëherë nga puna për të gjetur pasuesin e tij në katërkëndëshin e portës. Blutë e Londrës duket se e kanë gjetur zgjidhjen sërish në shtëpinë e Atletiko Madridit, e cila quhet Jan Oblak. Anglezët janë gati të paguajnë klauzolën e zgjidhjes së kontratës së portierit sloven, e cila kap shifrën e 100 milionë eurove. Si alternativë e Oblak, shihet edhe portieri anglez i Stok Siti, Xhek Butland.

Bernard shkon tek Evertoni

Evertoni fiton duelin në merkato me gjigantët italianë të Milanit dhe Interit për shërbimet e brazilianit Bernard. Anglezët duket se kanë arritur marrëveshje me futbollistin, i cili prej pak kohësh është pa kontratë pas përfundimit të asaj me Shakhtar Donetsk. Bernard ndiqet prej kohësh nga Milani, ndërkohë që edhe zikaltrit kishin shprehur interes për të. Për brazilianin interesohej edhe Uest Hemi, por duket se 26-vjeçari ka preferuar skuadrën nga Liverpooli për të vazhduar karrierën e tij.

Sanabria drejt Uest Hemit

Shitja e mundshme e Antonio Sanabrias nga Betis Sevilja në Premier Ligë te Uest Hemi do t'i sillte përfitime të konsiderueshme ekonomike edhe Romës, që zotëron gjysmën e kartonit të futbollistit. Sipas mediave spanjolle, klubi londinez është gati të paguajë 22.5 milionë euro skuadrës spanjolle, që për një shifër të tillë vështirë se do të thotë jo. Gjysmën e kësaj shumë do ta përfitonte Roma, në bazë të marrëveshjes së arritur mes dy klubeve për ndarjen në mënyrë të barabartë të kartonit të futbollistit paraguaijan. Për Sanabrian në fakt interesohej edhe Nica. Klubi verdhekuq shpreson që Betisi ta shesë lojtarin, për të rregulluar sadopak bilancin ekonomik.

Sassuolo me ofertë për mbrojtësin e Barcelonës

Sassuolo e ka bërë një ofertë 12 milionë euro për mbrojtësin e Barcelonës, Marlon, shkruan "Mundo Deportivo". Marlon për pak sa nuk iu bashkua Uest Hemit në fillim të kësaj vere, dhe tani ai do t'i shqyrtojë opsionet për të ardhmen e tij. Klubi italian dëshiron që të merr pjesë në garat evropiane, dhe ka filluar që të përforcohet me lojtarë të mirë, ata transferuan edhe ish-lojtarin e Milanit, Kevin Prins Boatengin nga Aindraht Frankfurti.



DASHI 21. mars - 20. prill

Neptuni do influencojë se tepërmi tek jeta juaj sentimentale dot. Do merrni disa vendime në çift të cilat do i japin një tjetër drejtim jetës suaj. Disa mund të kalojnë ndonjë moment të tensionuar. Beqaret duhet të bëjnë kujdes. Hëna do iu bëjë kërkesë dhe do kerkoni një "qenie" perfekte. Nuk keni për ta gjetur nese nuk tregoheni realiste. Me financat gjerat do shkojnë mire. Me në fund.



DEMI 21. prill - 21. maj

Gjate kesaj dite lidhja që keni krijuar do të përforcohet edhe me shume. Do jeni shume joshës dhe partneri do ndihet mire që iu ka në krah. Beqaret nga ana tjetër do kërkojnë pafund dhe do këne sukses. Me në fund edhe ju nuk do ndiheni me vetem. Financat duhet menaxhuar me shume maturi. Mos e humbni kthjelltesine dhe mos u hidhni me sy mbyllur në detin e shpenzimeve.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Edhe pse lidhja juaj është shume e rendeishme duhet të merreni pak me shume me veten dhe familjaret sot. I keni lene pas dore kohet fundit. Beqaret, edhe pse nuk është në stilin e tyre, do fillojnë aventura, e ardhmja e të cilave nuk dihet aspak. Marsi do influencojë me shume tek financat. Buxheti do të ekuilibrohet dhe ju do mund të beni pak me shume shpenzime sesa zakonisht.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Jeta juaj në çift mund të jete e tensionuar dhe aspak e animuar sot. Mundohuni ta ndreqni sa më pare sepse në të kundert situata mund të perkeqesohet me teper. Tregohuni pak me tolerante dhe të kuptueshem. Beqareve mund t'iu ndryshojë jeta teresisht fale një takimi impresionues. Financat do mbrohen nga Saturni. Do jete një dite pa probleme në kete fushë.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Ata që janë në çift do jete me të perkedhelur nga jete sot. Dita do jete shume animuar dhe e kendshme. Beni vetem kujdes mos tregoheni idealiste dhe mos kritikoni me shume sesa duhet. Beqaret do këne mundesi me shumice për të dale neper takime. Tregohuni sa më të hapur që të mundeni. Në planin sentimental duhet të tregoheni sa më vigjilente. Mos shpenzoni pa u menduar mire.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Humori juaj do të ndryshojë gjate kesaj dite dhe kjo mund të sjelle probleme me partnerin tuaj. Tregohuni të kujdesshem sepse perndryshe do kaloni një dite të veshitire. Beqaret do ndihen mire edhe ashtu si janë, por një person që do takoni do iu bëjë për vete dhe mund të lindin ndjenja të forta. Do e menaxhoni me kujdes buxhatin dhe do tregoheni të matur me shpenzimet. Bravo!



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Nuk do iu pelqejne aspak detyrimet dhe të zakonshmet në jeten tuaj në çift. Do kerkoni të provoni gjera të reja që t'iu sjellin me shume e mocione. Kujdes mos tentoni të shikoni dike tjetër sepse kur ta humbni partnerin do iu vijë shume keq. Jupiteri dpo jete planeti që do ndihmojë beqaret do iu sjelle fat. fale disa shpenzimeve të papritura që do beni financat do të dobesohen.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Marredhenia me partnerin do jete shume e mire. Lereni pas rutinen dhe [provoni gjera të reja se bashku. Do ndiheni mire dhe do iu duket sikur do të rilindni. Beqaret do takojne dike dhe do e idealizojne menjehere. Ky është gabimi me i madh. Mos nderton lidhje sot sepse do lendoheni. Periudhe e favorshme për financat. Plutoni do iu mbeshetese dhe do beni investimet e nevojshme.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Per disa prej atyre që janë në një lidhje dita do jete e veshitire dhe me probleme. Mos e humbni në asnje moment komunikimin me partnerin. Beqaret do jene të perkedhelurit e yjeve. Jo vetem që do këne takime interesante por mund të fillojnë edhe lidhje pasionante. Kujdes me operacionet e medha financiare. Situata nuk është shume e qendrueshme që ju të merrni vendime.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Projektet në çift do jene shume të favorizuara gjate kesaj dite. Shprehini secili mendimet dhe me pas vendosni për ate që iu intereson të dyve. Tregohuni edhe pak me të ngrohte me ate që keni në krah. Beqaret do marrin një propozim shume të vecante. Mendohuni mire para se të jepni pergjigje. Financat do jene në gjendje shume të mire sot. Mund të beni edhe ndonjë shpenzim me shume.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Duke qene se asnje planet nuk do ndikojë tek jeta juaj në çift pritet një dite e bukr dhe e mbushur me emocione. Do ndiheni me fat që do keni dike i partneri pranë. Saturni do i bëjë beqaret me të hapur ndaj takimeve. Mos humbisni asnje rast. Situata financiare do jete e pa stabilizuar. Do iu duhet të hiqni dore nga disa shpenzime që kishit menduar. Eshhtë me mire keshthu.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Në planin sentimental do keni disa probleme sot. Mos u panikoni por qetesohuni dhe flisni me shume me partnerin. vetem keshthu do mund të rivendosni klimen e ngrohte. Beqaret duhet të merren me shume me ceshjtjet e dashurise. Nese nuk kerkoni vete mos prisni që të tjeret t'ua servirin gjithcka. Ka mundesi që me financat të keni fat. Gjithsesi qendroni me kembe në toke.

		Mensur Mamuti	ROK GRUP AUSTRALIAN (INXS)	FSHATAR	VEPËR E AUTORIT NË FOTO KËNGËTARJA BILURDAGU	M		
		AJETI I PARË I ZBRITUR KURANOR						
		I PADJALLËZJAR, I THJESHËTË						
		VULLKAN NË SICILI						
		KUALIFIKIM (SHKURT)						
KOHA	GRUP UJDHESASH NË POLINEZI BRITMË E PULËS KUR BËN VEZË	B	I HEQ LËVOREN DIÇKAJE ÇOKAS KALIUMI	Ç	KIMISTI DHE SHPIKËSI SUEDEZ ALFRED	ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHIRER	KALLAJI VULLNETARË	Ë QË PËRMBAN ALEGORI
MBIEMRI DHE EMRI I AUTORIT DHE PËRKTHYESIT TONË NË FOTO								
FLORI			JASHË-ZAKONISHT E MADHE NATASHA SELA					
NJERINGRËNËS							KËNGËTARI I VERBER, ÇARLS SHOK	
NUK MARR PJESE NË NJË PUNE SHMANGËM								GERMANIUMI ISH FUTBOLLISTI KROAT, SLAVEN
SHKRONJË GREKE			METRI	LITRI PARTNERI I KOSTELOS (KOMEDI AMERIKANE)	PERSONAZH CIFUT NGA BIBLA KOMEDI E ANIMUAR AMERIKANE (OGR)			
KËNGËTARJA LIBOHOVA					JO NË KËMBË POZITANË SHTRAT QYTEZË NË ABRUZO TË ITALISE			
NDAJ FOLJË SASIE			SHFAQJA E NATYRSHMË E DRITES, AURORA KNOCK OUT					
JODI		ASTRONOMI POLAK, NIKOLA REOMIRI						AZOTI
VEPRIMTARI LETRARE PËR DASHURINË							KAFSHË BESNIKE SHTEPIAKE (PASHQI)	

ZGJIDHJET: M, IKRE, NAI, ETNA, KUAL, B, Ç, SN, Ë, KOKONA VEDAT, AR, KOLOSAL, KANIBAL, REJ, ABSTENOJ, GE, RO, I, NABOT, IRMA, SHTRIRË, SA, BOREALIS, J, KOPERNIK, EROTIKË, QEN.

Sudoku

shumë i lehtë									mesatar								
7	6	3	5	9	1	8	2	4	4	5	1	3	7	8	9	2	6
9	8	4	7	6	2	3	1	5	2	3	8	6	9	4	7	5	1
2	1	5	4	3	8	7	9	6	7	6	9	2	5	1	4	8	3
1	3	7	8	5	9	6	4	2	1	7	5	8	3	2	6	9	4
5	9	2	3	4	6	1	8	7	9	4	2	7	1	6	8	3	5
6	4	8	2	1	7	9	5	3	6	8	3	5	4	9	2	1	7
3	5	1	9	7	4	2	6	8	3	2	7	4	8	5	1	6	9
8	7	9	6	2	5	4	3	1	5	1	6	9	2	7	3	4	8
4	2	6	1	8	3	5	7	9	8	9	4	1	6	3	5	7	2

Shumë i lehtë: 763591824, 984762315, 215438796, 137859642, 592346187, 648217953, 351974268, 879625431, 426183579. Mesatar: 451378926, 238694751, 769251483, 175832694, 942716835, 683549217, 327485169, 516927348, 894163572.

12-VJEÇARI SHKON NË UNIVERSITET

Carlos Santamaria Diaz është studenti më i ri që është pranuar në Universitetin Kombëtar Autonom të Meksikës. Vetëm 12 vjeç ai është një gjeni në fushën e fizikës biomjekësore. Djali nga Guadalajara perëndimore, iu nënshtrua një provimi fizike që më pas do t'a bënte atë pjesë të Universitetit Kombëtar të Meksikës. Deri në moshën 9-vjeçare, ai mori pjesë në programe të ndryshme universitare në kimi analitike, biokimi dhe biologji. "Nuk jam një gjeni, jam një fëmijë i lumtur", u shpreh Carlos. Por inteligjenca e tij duket sikur nuk ka kufinj pasi Carlos Diaz i ka ofruar disa këshilla presidentit të zgjedhur të Meksikës Andres Manuel Lopez Obrador për mënyrën sesi duhet ta qeverisë Meksikën. "Së pari, do t'i thosha atij të mos bëjë të njëjtat gabime si presidentët e mëparshëm. Poli-



tikanët duhet të kujdesen për vendin sikur kujdesen për vete. Ky vend është plot me njerëz që kanë ëndrra dhe në të njëjtën kohë nuk i realizojnë dot ëndrrat

sepse nuk kanë mundësi", tha ai. 12-vjeçari ka kërkuar që në universitet të trajtohet njëllëj si studentët e tjerë pa privilegje ose përfitime të veçanta.



Rikthehen Olio dhe Stelio

Olio dhe Stelio rikthehen në ekranin e madh. Dyshja ikonë e filmave komikë, e formuar nga Stan Laurel dhe Oliver Hardy do të vijë në një format kinematografik të prodhuar nga BBC Films. Filmi biografik kushtuar legjendarëve të komedisë së viteve 1930-1950, do të interpretohet nga dyshja Steve Coogan dhe John Reilly. Aktorët e rinj kanë një ngjashmëri të pabesueshme me personazhet. Tregimi biografik risjell historinë e një miqësie të jashtëzakonshme, atë të çiftit britaniko-amerikan, gjatë turneut të fundit të tyre në Britaninë e Madhe, në vitin 1953. Një vëmendje e veçantë në film mësohet se do t'u jepet edhe dy bashkëshorteve të aktorëve, duke i dhënë një tjetër dritë, pak të njohur deri më sot, dyshes së paharrueshme të komedisë botërore.

Po, mund të mbetesh shtatzënë kur je shtatzënë

Fertiliteti ndryshon shumë nga një grua te tjetra. Disa mund të mbeten shtatzënë shumë lehtë, ndërsa të tjera janë të detyruara të ndjekin disa alternativa derisa të arrijnë rezultatin. Disa mezi presin për të mbetur shtatzënë, ndërsa disa e shmangin haptazi atë. Por a mund të mbesin femrat shtatzënë ndërkohë që ato janë shtatzënë?

Nëse po lexoni këto rreshta dhe jeni të habitur, nuk jeni të vetmit. Është një pyetje tronditëse dhe përgjigja është edhe më tronditëse. Rezultoni se mund të ngelesh shtatzënë ndërkohë që je tashmë shtatzënë. Fenomeni njihet si superfetimi dhe është jashtëzakonisht i

rrallë, por ndodh.

Connie Hedmark, një obstetër nga Michigan, tha për BabyCentre: "Hormonet e shtatzënisë zakonisht mbyllin sistemin e një gruaje, duke e bërë të pamundur që të ndodhë ovulacioni gjatë shtatzënisë së saj". "Kjo është arsyeja pse superfetimi është kaq i jashtëzakonshëm".

Askush nuk e di pse ndodh kjo, por disa besojnë se ndodh kur implantimi i embrionit vonohet që të parandalojë hormonin. Mungesa e njohurive mbi këtë dukuri ndodh ndoshta për faktin sepse është shumë e rrallë. Studiuesit e superfetimit kanë identifikuar vetëm 10 raste të tilla.



Tërhiqen prezervativët Durex, mund të çahen

Durex ka tërhequr mbrapsht disa pako me prezervativë nga frika se mund të çahen. Paketat "Real Feel" dhe "Latex Free" nuk arritën të kalonin testet e presionit të çarjes, njoftoi Durex.

Të gjithë prezervativët janë prodhuar këtë vit dhe kanë dalë në shitje në Britaninë e Madhe. Ato kanë një afat skadence nga dhjetori 2020 deri në shkurt 2021. Durex thotë se prezervativët e

tërhequr nga kompania mund të shpërthejnë më kollaj se ato normale dhe autoritetet shëndetësore paralajmërojnë se kjo mund të çojë në një rrezik të shtatzënisë së padëshiruar ose sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Njerëzit janë paralajmëruar të mos përdorin prezervativët nëse mendojnë se mund të çahen dhe t'i kthejnë ato për rimbursim. Durex, një nga prodhuesit më



të mëdhenj të prezervativëve në botë Mbretërinë e Bashkuar, i tërhoqi produktet më 3 gusht.

1516 - Mbreti Charles I dhe Francois I nënshkruajnë Traktatin e Noyons.

1521 - Spanjollët pushtojnë Tenochtitlan (Mexico City) nga Actekët.

1624 - Kardinali Richelieu emërohet kryeministër i Francës nga ana e Luigjit XIII.

1704 - Forcat franceze dhe bavareze shkatërrohen nga ushtritë e kombinuara të britanike, gjermane dhe holandeze në Blenheim, Gjermani.

1740 - Grevë urie në Rotterdam.

1914 - Franca i shpall luftë Austro-Hungarisë, që shpie drejt Luftës së I Botërore.

1923 - Kongresi Kombëtar turk zgjedh Mustafa Kemal Pashën për kryetar.

1937 - Japonezët sulmojnë Shangan.

1951 - Britania e Madhe dhe Iraku nënshkruajnë marrëveshje të re për naftën.



Tani të gjithë mund të bien dakord për një studim nga Universiteti i Massachusetts, botuar në një numër të veçantë të Journal British Sports Medicine, të cilët shqyrtuan 38 kërkime mbi përfitimet dhe modelet e ecjes në aspektin e hapave në minutë, ritmin e zemrës dhe ritmin e frymëmarrjes. Pavarësisht nga larmia e subjekteve dhe rasteve të shqyrtuara (qindra burra dhe gra të moshës 18 vjeç e lart me indekset e masës së trupit të ndryshueshëm), studimi, i kryer nga Catrine Tudor-Locke, arriti në përfundimin se për ecje të shpejtë duhet të kuptojmë mesatarisht 100 hapa në minutë. Sigurisht më pak nga sa kishim menduar, madje edhe për ata që janë në formë mund të rezultojnë në një ritëm mjaft të ngadaltë.

STRESI

Një profesor i psikologjisë po mbante një ligjëratë se si mund të hiqet stresi.

- Para se të flini, largojini të gjitha problemet nga mendja, thjeshtë nxirrini jashtë dyerve të shtëpisë..., tha ai!

- Dmth, na thua që edhe gruan mund ta nxjerr jashtë - ndërhyri një student i martuar!



Mosha nuk ka rëndësi, nëse nuk je djathë. (Billie Burke)



KALENDARI HISTORIK 7 GUSHT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS